



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:040547

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05497173

**PKR.nr.339/23**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Krime të Rënda**, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Alban Ajvazi kryetar dhe gjyqtaret profesioniste Alltën Murseli dhe Gëzim Ademi, anëtare të trupit gjykues, në çështjen penale kundër të akuzuarve L.K, për shkak të veprave penale se në vazhdimësi dhe bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Ushtrim i ndikimit nga neni 424 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuarit L.K në bashkëkryerje për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i akuzuari L.K dhe F.D në bashkëkryerje për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i akuzuari L.K për shkak të veprës penale Mos raportimi ose raportimi i remë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 430 par.2 të KPRK-së, e akuzuara M.B për shkak të veprave penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.1 të KPRK-së dhe Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituar me kryerjen e veprës penale sipas nenit 333 par.1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rëna PP.I.nr.13K/2021 të dt.13.08.2021, pas mbajtjes të shqyrtimit gjyqësor, në të cilat kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Arbresha Shala, të akuzuarit L.K me mbrojtësin e tij sipas autorizimit Av.Ramë Gashi, M.B me mbrojtësin e saj sipas autorizimit Av.Fatlum Podvorica, F.D me mbrojtësin e saj sipas autorizimit Av.Arlind Jupolli, më datë 16.02.2024, mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me datë 25.03.2024 përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **Të akuzuarit:**

**L.K**, nga i ati H. dhe nëna M.1, e gjinisë M.2, i lindur më ..., në fshatin ..., Komuna Malishevë, me vendbanim në lagjen ..., me profesion jurist, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**M.B**, nga i ati M. dhe e ëma H. (me mbiemër të vajzërisë, Zh.), i lindur më ..., në Prishtinë, me vendbanim në ..., e pa martuar, juriste, me nr. personal 1174892721, Shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

**F.D**, nga i ati H.1 dhe e ëma H.2 (me mbiemër të vajzërisë, Sallahi), i lindur më ..., në Prishtinë, me vendbanim në ... në Prishtinë, në një bashkëjetesë, me një fëmijë, juriste, me nr. personal ..., Shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

Konform nenit 363 par.1 pika 1.3 KPPRK-së.

## **LIROHEN NGA AKUZA**

I. I akuzuarit L.K:

### **Sepse**

Në janar të vitit 2018, kryesisht ne lokalën “S...” në lagjen Dardania, gjithashtu me datën 04.12.2019 në rrugën kryesore në lagjen “Dragodan”, me datën 06.12.2019 në rrugën Prishtinë-Qagllavic në qendrën tregtare Grandstore, gjithashtu në lokalën e B.M në Podujevë, si dhe më datën 16.12.2019 në rrugën “FehmiAgani“ në zyrën e Noterit Sefadin Blakaj, në cilësinë e personave zyrtar, i pandehuri L.K – në cilësinë e ..., i pandehuri A.K, në cilësinë e shoferit personal (familjar) i të pandehurit L.K në bashkëkryerje, në vazhdimësi, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, kanë kërkuar dhe pranuar të holla dhe dhuratat për vete dhe për tjetrin nga B.M, në atë mënyrë që përmes të pandehurit A.K disa herë kanë pranuar të holla, duke arritur shifrën prej 40.000 €, po ashtu të pandehurit, kanë pranuar si dhuratë, një veturë të tipit “VË T-roc”, me ngjyrë të bardhë, me tabela të regjistrimit ... në vlerën prej 25.000 €, për asistentën e të pandehurit L.K, të pandehurën M.B. Këto përfitime janë pranuar nga të lartpërmendurit, duke premtuar se do të ushtrojnë ndikimin e tyre mbi vendimmarrjen e personit zyrtar , në Kolegjin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, për uljen e dënimit, sipas Kërkesës për Mbrojtje të ligjshmërisë, për të dënuarin B.M, si dhe të shtyhet ekzekutimi i dënimit për te njëjtin, i cili sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë është gjykuar me dënimin me burg prej 4 vite e 7 muaj, ndërsa nga Gjykata e Apelit i është zvogëluar dënimi në 3 vite e 7 muaj,-

- me këtë në vazhdimësi dhe në bashkëkryerje, kishte për të kryer veprën penale Ushtrimi i Ndikimit nga neni 424 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

II. I akuzuari L.K (sipas pikës IV te aktakuzës)

### **Sepse**

Në muajin shtator të vitit 2020, në cilësinë e personave zyrtar, i pandehuri L.K – në cilësinë e ..., i pandehuri A.K, në cilësinë e shoferit personal (familjar) i të pandehurit L.K, ashtu qe kanë ndërmarr veprime për pengimin e arrestimit nga policia e të dyshuarit A.M, për dyshimin e kryerjes së veprës penale Vrasje e Rëndë në Tentativë, në atë mënyrë që, i pandehuri L.K, përmes të pandehurit A.K (shofer personal), i kanë mundësuar të dyshuarit A.M që të arratiset nga territori i Republikës së Kosovës, për në Shqipëri. E gjithë kjo ka ndodhur, duke e shfrytëzuar veturën zyrtare të ..., ku gjatë arratisjes kanë përdor letrën me logon zyrtare edhe dritat rotative të cilat i posedonte kjo veturë, me qëllim që t’iu jepet përparësi kalimi dhe të kalojnë pa u penguar nga policia, duke depërtuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, të gjitha këto veprime nga të pandehurit janë bërë për shkak të obligimeve që kane pasur ndaj B.M lidhur me veturën dhe shumën e të hollave të pranuar,

- me këtë në bashkëkryerje kishte për të kryer veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, sipas nenit 414 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së;

### III. I akuzuari L.K, (sipas pikës VI te aktakuzës)

#### **Sepse**

Me datën 31.03.2020, në Prishtinë, nuk ka paraqit të dhënat e kërkuara në deklaratën për deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, edhe pse sipas ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtar, Ligji nr.04/L-050, ka qenë i detyruar ta bëj këtë, ashtu që në deklaratë nuk ka përfshirë shumën e të hollave prej 40.000 (dyzet mijë) €, të cilat i ka pranuar nga F.A për shitjen e banesës, si dhe të hollat në shumën prej 10.000 (dhjetë mijë) €, të cilat ia ka dhënë mikut të tij A.Z, në emër të blerjes së dy banesave në kompleksin e “Pozhegu Brothers”, blloku C-11/ C-23, lagjja “Mati” në Prishtinë në vlerë prej 121.000 € (njëqind e njëzet e një mijë euro),

- me këtë kishte për të kryer veprën penale Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 430 par. 2 të KPRK-së

### IV. Të akuzuarit: L.K dhe F.D,(sipas pikës V te aktakuzës)

#### **Sepse**

Në muajin shkurt të vitit 2021, në selinë e ..., duke vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik (Ligji nr.04/L-042, neni 7, Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi, neni 8, Planifikimi i Prokurimit), dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për tjetrin, në cilësinë e personave përgjegjës kanë shkelur procedurat dhe rregullat e prokurimit publik, në atë mënyrë që kanë predikuar fituesin dhe kanë diskriminuar operatorët e tjerë ekonomik, duke favorizuar Operatorët Ekonomik “G...” dhe “S...” si dhe përkundër vendimit të ..., në fillim të vitit kalendarik, i cili në kuadër planifikimit të prokurimit kontrata e KPK-së ka qenë e lidhur me Operatorin Ekonomik “M...”. Të njëjtit kanë porositur dhe pranuar mobile në vlerë prej 9,480.00 € (nëntë mijë e katërqind e tetëdhjetë euro), e që pas disa ditësh është lidhur kontrata dhe janë zhvilluar procedura fiktive, në kundërshtim me dispozitat e cekura më lartë,

- me këtë në bashkëkryerje kishin për të kryer veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, sipas nenit 414, par. 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

### VI. E akuzuara M.B,(sipas pikës VII te aktakuzës)

#### **Sepse**

Me datën 16.12.2019, në zyrën e noterit Sefadin Blakaj në Prishtinë ne rrugën “Fehmi Agani”, nr.21/3-1, pranon pasurin për të cilën e di se është fituar me vepër penale, ashtu që veturën të tipit “VË T-roc”, me ngjyrë të bardhë, me tabela të regjistrimit ... në vlerën prej 25.000 €, e pranon nga i dëmtuari B.M, edhe pse është e vetëdijshme se vetura në fjalë është si rezultat i veprës penale të shkaktuar nga të pandehurit L.K dhe A.K,

- me këtë kishte për të kryer veprën penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve te përfituar me kryerjen e veprës penale sipas nenit 333, par.1 të KPRK-së.

Sepse nuk është provuar se të akuzuari kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar

Konform nenit 364 KPRK-së, e akuzuara M.B

## ËSHTË FAJTOR

E akuzuara M.B,(sipas pikës II te aktakuzës)

Sepse

Me datën 16.12.2019, ka përpiluar dokument të falsifikuar, me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal, kështu që në deklaratën e datës 16.12.2019, të cilën e ka bërë në emër të B.M, të nënshkruar kinse nga ai dhe e pandehura, sipas së cilës deklaratë e pandehura pretendonte se i ka paguar të njëjtit shumën e të hollave prej 8.400 (tetë mijë e katërqind) € në zyrën e noterit Sefadin Blakaj në Prishtinë në rrugën Fehmi Agani, 21/3-1, si dhe dënimet kundërvajtëse në vlerë prej 600 (gjashtëqind) €, mirëpo nga raporti i ekspertimit të Agjencisë Kosovare për Forenzikë, me nr. AKF/2021-0908/2021-850, të datës 21.04.2021, u vërtetua se nënshkrimi i B.M që gjendet në këtë dokument nuk është i tij,

- me këtë ka kryer veprën penale Falsifikimi i dokumenteve sipas neni 390, par.1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata konform dispozitave 7, 17, 21, 38, 43, 69, 70, 79, të KPRK-së, si dhe nenet 358, 360, 364, 367, 449 të KPRK-së, të akuzuarën e:

## GJYKON

**DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 3,000 (tremijë) EURO**, i cili dënim do të ekzekutohet brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në të cilin dënim e shqiptuar do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej dt.01.03.2021 deri me dt.31.03.2021.

Nëse e pandehura nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par 3 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t'ia zëvendësojë me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.

Urdhërohet që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, vetura e sekuestruar e tipit "VW T-roc", me ngjyrë të bardhë, me tabela të regjistrimit ..., të i kthehet pronares M.B.

Detyrohet e akuzuara që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, detyrohet që t'i paguaj shpenzimet dhe atë, shumën prej 200 (dyqind) Euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave gjithsecili shumën prej 50 euro, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar B.M, ... në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

## **A r s y e t i m**

### ***Rrjedha e procedurës:***

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.13K/2021 të dt.13.08.2021, kundër të akuzuarve L.K, A.K, M.B dhe F.D, për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar mirë, se të njëjtit kanë kryer veprat penal si në hyrje të këtij aktgjykimi.

Gjykata me aktgjykimin nën shenjë PKR.nr.484/21 të datës 25.04.2023, ka vendosur lidhur me aktakuzën e prokurorisë.

Gjykata e Apelit me aktvendimin nën shenjë PAKR.nr.400/23 të datës 17.10.2023, ka aprovuar ankesat e palëve dhe është anuluar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata lidhur me këtë çështje penale dhe duke vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës së shkallës së dytë ka caktuar dhe mbajtur seancën e rishqyrtimit gjyqësor me datën 09.01.2024, ku kanë prezantuar të gjitha palët, përveç të akuzuarit A.K, i cili edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt mungesën nuk e ka arsyetuar dhe sipas njoftimit të policisë së Kosovës të datës 04.01.2024 i njëjti nuk gjendet në Kosovë. Gjykata pas marrës së mendimit nga palët ka veçuar procedurën për të njëjtin me aktvendimin e datës 09.01.2024 dhe për të njëjtin do të zhvillohet procedurë e veçantë.

Gjykata ka vazhduar seancën e rishqyrtimit gjyqësor me të akuzuarit tjerë dhe pas njoftimit me të drejtat dhe obligimet e tyre dhe leximit të aktakuzës të akuzuarit janë deklaruar të pa fajshëm, ku është vazhduar me fjalën hyrëse nga palët, është dëgjuar dëshmitari bashkëpunues B.M dhe me propozimin e prokurorit të shtetit dhe pëlqimin e palëve, gjykata ka lexuar deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në shqyrtimet e kaluar dhe atë: B.D dhënë në shqyrtimin e datës 31.03.2022, A.M, F.S, B.L dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 08.04.2022, B.P, B.B, S.B, E.SH, L.D të dhënë në shqyrtimin e datës 20.04.2022, F.K, H.S, Z.K.D, I.H të dhënë në seancën e shqyrtimit të datës 05.07.2023, V.C, F.L të dhënë në seancën e shqyrtimit të datës 06.07.2022, janë administruar provat materiale si dhe me propozimin e prokurorit të shtetit, gjykata ka angazhuar ekspertin nga lëmia e prokurimit publik, lidhur me dispozitivin V të aktakuzës dhe ka ftuar që në cilësi të dëshmitarit A.Z dhe F.A ku janë dëgjuar në rishqyrtimin gjyqësor të datës 16.01.2024.

Tutje është vazhduar me rrjedhën e procedurës si në vijim:

### ***Fjala përfundimtare e palëve:***

Prokurori i shtetit, në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se mbesë në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të kaluar të datës 06.02.2023, ku të njëjtën e kishte dorëzuar me shkrim dhe të elaboruar gojarisht, dhe kishte deklaruar se nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor bindshëm është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktakuzës, duke shtuar se nga dëshmia e dëshmitarit bashkëpunues B.M janë vënë në pah të gjitha veprimet e ndërmarra nga të akuzuarit L. dhe A.K, për të i hequr dënimet të dënuarit B.M,

kundrejt pranimi të dhuratave dhe përfitimeve tjera në emër të ushtrimit të ndikimit në vendimmarrjen e persona zyrtar, dhe se në këtë drejtim, dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshme, shumave të hollave dhe veturës që kishin pranuar nga dëshmitari B.M, të akuzuarit L. dhe A., përkatësisht i akuzuari L. i jap veturën të akuzuarit A. i cili ka qene edhe shoferi i tij personal, për ta larguar A.Mn, për në Republikën e Shqipërisë, me qëllim që të i shmanget arrestimit, nga organet e ndjekjes. Po ashtu ka shtuar se kjo dëshmi është në përputhje edhe me dëshmit e dëshmitarëve A.M, I.S, B.P dhe F.K, S.B, dhe provave materiale siç janë bisedat në Whatsup, nga të dhënat e sistemit për menaxhimin e kufirit, si dhe provat tjetra, nga të cilat rezultojnë të vërtetuara veprimet inkriminuese, të kryera në bashkëpunim ndërmjet këtyre të akuzuarve, duke qenë plotësisht në dijeni për veprimet e njëri-tjetrit, veprime këto që konsistojnë edhe në interesimin e të akuzuarit L. rreth rastit të A.M, djalit të dëshmitarit B.M, që siç e ka pohuar edhe vetë, për këtë çështje e ka kontaktuar ..., duke mos qenë në gjendje të sqaroj arsyen që e ka shtyrë për një veprim të tillë, por që është e qartë, motivi ka qenë përfitimi i kundërligjshëm. Po ashtu ka shtuar se është vërtetuar se të akuzuarit L.K dhe F.D, duke shfrytëzuar pozitat e tyre zyrtare kanë bërë iniciimin e procedurës së prokurimit në kundërshtim më dispozitat ligjore meqenëse iniciimi i kërkesës është dashur të bëhet nga udhëheqësi i Divizionit për shërbime të përgjithshme dhe jo nga asistentja e të akuzuarit, se nuk është dashur në asnjë mënyrë të nënshkruhet një kontratë e re, përderisa ka qenë në fuqi kontrata me operatorin “M...”, pastaj sjellja e mobileve është bërë para lidhjes së kontratës, duke e bërë kështu të gjitha procedurës fiktive, meqenëse paraprakisht është ditur fituesi i tenderit, dhe se këto rrethana janë vërtetuar nga provat e administruara, dëgjimi i dëshmitarëve dhe provave materiale, nga ku vërtetohen veprime e tyre inkriminuese. Më tutje ka shtuar se lidhur me të akuzuarin L.K është vërtetuar edhe vepra penale Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 430 par.2 të KPRK-së pasi që ky i akuzuar, nuk ka deklaruar shumën e parave të pranuar në llogarinë e tij bankare në lartësi prej 40.000.00 euro, dhe gjithashtu blerjen e banesave, të cilat i kanë pasur në posedim dhe ka investuar në të njëjtat. Po ashtu, ka pretenduar se të akuzuarit A.K dhe M.B kanë kryer veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.2 lidhur me par1 të KPRK-së përkatësisht, e pandehura M... veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.2 lidhur me par1 të KPRK-së, ashtu që i akuzuari A. ka bërë falsifikimin e raportit të ekzaminimit mikrobiologjik për Covid-19 për dëshmitarin B.M, që siç është vërtetuar të njëjtin ja ka dërguar në Whatsup me qëllim që ta përdor të njëjtin për të i shmangur ekzekutimit të dënimit, ndërsa që e akuzuara M.B ka bërë falsifikimin e kontratës së shitblerjes së veturës me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal, ashtu që është nënshkruar edhe në emër të B.M, e që në deklaratë, është konstatuar se e akuzuara M.B ka paguar shumën prej 8.400 euro në emër të çmimit të veturës në zyrën e noterit S.B në Prishtinë, dhe dënimet kundërvajtëse në emër të veturës në shumë prej 600 euro, e që siç është vërtetuar nga Raporti i ekspertimit të Agjencisë Kosovare të Forenzikes i dt.21.04.2021 por edhe nga vete pohimi i B.M, nënshkrimi është i falsifikuar. Prokuroria pretendon të vërtetuar edhe faktin se e akuzuara M.B, ka konsumuar elementet e veprës penale “Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par.1 të KPRK-së, pasi që ka pranuar si dhuratë veturën e tipit “VË T-roc”, duke e ditur se e njëjta është përfituar me kryerjen e veprës penale nga të akuzuarit L. dhe A.K. Në fund duke vlerësuar se mbrojtja e të akuzuarve është thelbsisht e pambështetshme, i ka propozuar gjykatës që të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit, duke marrë parasysh të gjitha

rrethanat rënduese siç është qenia e tyre persona zyrtar të lartë në detyrë, veprimet janë kryer me dashje direkte dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, nuk kanë shprehur keqardhje, dhe se këto vepra po paraqesin pengesë në integrimin evropian të Republikës së Kosovës, ndërsa që si dënim plotësues të u shqiptohet ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik, në pajtim me nenin 59 par.1 nënpar.2.3 lidhur me nenin 62 të KPRK-së dhe ka shtuar se nga provat e administruara në seancën e rishqyrtimit gjyqësor, ka vërejte në ekspertizën e prokurimit publik dhe sqarimet e saj lidhur me pikën V të aktakuzës, po ashtu nga dëgjimi i dëshmitarit F.A dhe A.Z të dhënë në këtë shqyrtim është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar në dispozitivin e aktakuzës.

Mbrojtësi i të akuzuarit L.K, av. Ramë Gashi, ka deklaruar se mbesë në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të kaluar të datës 07.03.2023, ku të njëjtën e kishte dorëzuar me shkrim dhe të elaboruar gojarisht, ku kishte deklaruar se në seancën e caktuar për dhënien e fjalës përfundimtare, të cilën fjalë përfundimtare e ka dorëzuar në formë të shkruar, ndërsa që e ka elaboruar gojarisht, ka deklaruar se nga provat e administruara nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar, pasi që lidhur me veprën penale të përshkruar si në pikat I dhe IV të dispozitivit të aktakuzës, ka theksuar se aktakuza mbështet vetëm në deklaratat e dëshmitarit B.M dhe transkriptet e bisedave të zhvilluar në mes B.M dhe L.K, që janë prova të papranueshme, ndërsa që edhe vetë dëshmi e B.M është marr në kundërshtim me ligjin, duke i premtuar përfitime të kundërligjshme dhe duke e shpallur dëshmitar bashkëpunues në shkelje të dispozitave ligjore. Po ashtu ka shtuar se i mbrojturi i tij ngarkohet për veprime të cilin nuk kanë qenë përgjegjësi e tij, duke qenë se përgjegjësi për zhvillimin e procedurave të prokurimit është përgjegjës njësia e prokurimit, përveç nënshkrimit të kërkesës për inicimin e procedurës së prokurimit e cila është bërë nga njësia kërkuese, disponueshmeri e mjeteve për të cilat ka ekzistuar nevoja dhe buxheti i konfirmuar nga zyrtari kryesor administrativë dhe aprovimi i vendimit për komisionin për vlerësimin e tenderit, andaj, i akuzuari L. nuk ka qenë në gjendje ta favorizoj apo diskriminoj ndonjë operator ekonomikë, meqenëse nuk ka qenë fare i përfshirë në procedurën e prokurimit. Sa i përket veprës penale Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 430 par.2 të KPRK-së, mbrojtja pretendon se fakti i mos përfshirjes së shumës prej 40.000 euro është pasoj e fakti që i akuzuari L. ka qenë nën masën e arrestit shtëpiak dhe nuk ka pasur asnjë mundësi që të jetë në dijeni se xhirollogarinë e tij ka kaluar kjo shumë monetare dhe duke qenë se ende ka qenë në posedim dhe pronësi të banesës në sipërfaqe prej 59.30m<sup>3</sup> në emër të shitjes së të cilës ka pranuar shumë prej 40.000 euro, nuk ka mundur që të i deklaroj të dy këto, pasi që ka ekzistuar rreziku i deklarimit të rrejshëm. Po ashtu edhe sa i përket shumës prej 10.000 euro, të njëjtën ja ka dhënë mikut të tij A.Z në emër të borxhit siç ka deklaruar edhe në formularin e deklarimit të pasurisë nga viti 2017, dhe jo në emër të blerjes së banesave nga i njëjti, meqenëse titullar i banesave ende figuron A.Z. Në këto kushte, ka kërkuar nga gjykata, që ndaj të mbrojturit të tij nxirret aktgjykim lirues, për veprat penale për kryerjen e të cilave akuzohet. Në seancën e rishqyrtimit gjyqësor ka shtuar se provat qoftë në formë të dëshmisë qoftë në formën shkruar të nxjerra në rigjykim si prova të reja, madje këto në deklaratën e dëshmitarit nga seanca e kaluar dhe ekspertiza me shkrim si dhe dëshmia ekspertes në seancën e sotme i shtojnë fuqi dhe argument pluse, përveç atyre të dhëna më herët

I akuzuari L.K në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e mbështesë në tërësi fjalën përfundimtare të dhënë nga mbrojtësi im.

Ndërsa në mbrojtjen e tij i akuzuari L.K ka deklaruar, se mbesë në tërësi pranë deklaramit të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të kaluar të datës 05.10.2022 ku kishte deklaruar se shfrytëzon të drejtën për të mos u deklaruar në këtë çështje penale, pasi që sipas tij rasti ka qenë i montuar, janë ndërmarr veprime në mënyrë kundërligjore nga një prokuror i cili nuk ka pasur mandat ligjor si prokuror i Krimeve të Renda, në kohën e ndërmarrjes së veprimeve hetimore kundër të njëjtit. Në deklaratën e dhënë në procedurën paraprake, përkatësisht në deklaratën e dhënë në Polici me dt.01.03.2021, ka deklaruar se është Drejtor i përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurial të Kosovës që nga vitit 2015, A.K ka qenë shofer i tij për dy vite deri në muajt Tetor-Nëntor të vitit 2020 kur ka dhënë dorëheqje për arsye familjare, ndërsa që raporte familjare nuk kanë pasur në mes vete. Me B.M është takuar njëherë dhe atë kur zyrtarja e këshillit me propozimin e A.it ka dashur të blej një veturë prej të njëjtit dhe biseda është zhvilluar lidhur me veturën, takimi është bërë në Restorantin “Gizzi”, tek Grand Store, në muajin nëntor 2019, sa i kujtohet. Ka mohuar se është zhvilluar bisedë për ndonjë temë tjetër, të i ketë premtuar B.M për ndihmë në ndonjë çështje penale, mirëpo që ka pranuar se ndërkohë nga A.K është biseduar lidhur me rastin e B.M, një problemi familjar të djemve të tij dhe për këtë rast ka biseduar me kryeprokurorin nuk i kujtohet a është takuar fizikisht apo ka biseduar përmes telefonit, mirëpo nuk ka kërkuar asnjë favor nga i njëjti. Ka shtuar se kurrë nuk e ka ndihmuar askënd për tu arratishtë, as B. dhe A.M dhe as që ka qenë në dijeni nëse shoferi i tij tani i akuzuari A.K te këtë shfrytëzuar veturën zyrtare për një transport të tillë për A.M jashtë Republikës së Kosovës për në Republikën e Shqipërisë dhe asnjëherë nuk i ka ndihmuar B.M lidhur me ndonjë rast gjyqësor, dhe as që ka dijeni për çka është dënuar, sa është dënuar dhe kur është dënuar i njëjti. Sa i përket zhvillimit të procedurave të tenderimit për blerje të mobiljeve për zyre, ka theksuar se ekziston kontrata në mes këshillit Prokurial dhe Kompanis “M...” Sh.P.K, për furnizim me mobilja, mirëpo që kjo është çështje njësisë së Prokurimit në kudër të KPK-së, dhe në këtë drejtim kurrë nuk ka pasur kurrfarë përfitimi dhe nuk e ka ndihmuar askënd. Në deklaratën e dhënë në prokurori me dt.24.03.2021 ka deklaruar se të gjitha procedurat e prokurimit zhvillohen nga zyra e prokurimit, dhe në këtë drejtim edhe procedura për furnizim me mobileje ekskluzive për zyrën e kryesuesit, është zhvilluar nga kjo zyre, sipas kërkesës së njësisë kërkuese, janë themeluar komisionet dhe është përzgjedh fituese. Përgjegjësia e tij si ZKA, ka qenë, aprovimi i planit, kërkesave që paraqiten në bazë të nevojave dhe themelimi i komisioneve përkatëse, ndërsa që gjithë pjesa tjetër nuk është në përgjegjësin e ZKA-së dhe se edhe në rastin konkret kështu është vepruar. Po ashtu në Polici me dt.28.05.2021, ka deklaruar se deklarimin e pasurisë për vitin 2020 e ka bërë përmes email-it, dhe me at rast ka deklaruar banesën rreth 60m<sup>2</sup> se bashku me garazh, token në fshat, veturën dhe te hyrat personale. Banesën ku jeton ka bërë marrëveshje për ta shitur, por nuk ka kontratë të notorizuar për shkak se banesa nuk ka pranuar teknik, çmimi ka qenë 55.000.00 euro, ndërsa garazha 10.000.00 euro, nga të cilat nga blerësi F.A ka pranuar shumën prej 40.000.00 euro në xhironlogarinë bankare. Sa i përket blerjes së banesave në kompleksin O.E. “Pozhegu Bradhers”, ka theksuar ka biseduar me mikun e tij A.Z, i cili sa e din është pronar i 3 apo 4 banesave në atë vend, mirëpo vetëm ka kërkuar, ofertën nga i njëjti, edhe duke pasur parasysh se të njëjtit me herët ja ka huazuar shumën prej 10.000.00 euro, të cilën ka planifikuar të ja llogaris në kuadër të çmimit ndërsa që pjesën tjetër të ja paguar përmes kredisë.



Ndërsa që të gjitha komunikimet që ka bërë me persona të tretë për këto banesa kanë qenë rreth planifikimit të tij për blerjen e tyre dhe investimeve eventuale në të njëjtat. Po ashtu ka shtuar se nuk ka kurrfarë njohurie lidhur me raportin e mikrobiologjisë i falsifikuar në emër të B.M, i cili si foto është gjetur në telefonin e tij, siç e ka pohuar faktin se ka qenë prezent me rastin e lidhjes së kontratës për blerjen e veturës në mes M.B dhe B.M. Në fjalën përfundimtare në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se e përkrah fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, dhe nuk kam diçka tjetër për të shtuar.

Mbrojtësi i të akuzuarës M.B, av.Fatlum Podvorica, ka deklaruar se mbesë në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të kaluar të datës 07.03.2023, ku të njëjtën e kishte dorëzuar me shkrim dhe të elaboruar gojariisht, ku kishte deklaruar se nuk është vërtetuar ekzistimi i elementeve të veprave penale për kryerjen e të cilave është akuzuara e mbrojtura e tij, dhe në këtë drejtim ka përmendur faktin se e njëjta automjetin e tipit “Volkswagen” me targa të regjistrimit ..., e ka blerë nga B.M, sipas kontratës noteriale të shitblerjes, dhe se pagesën e të njëjtit e ka bërë përmes kredisë të marr në bankën TEB në shumë prej 17.000 euro, dhe nuk e ka pranuar si dhuratë nga ndonjë person i teret përfshirë të akuzuarit L. apo A.K, dhe se kjo konfirmohet edhe nga fakti që siç rezulton nga gjendja e llogaris bankare, shuma në emër të blerjes së veturës i është transferuar në llogari B.M, andaj edhe bazuar në këtë rrethana të vërtetuar nuk mundet blerja e automjetit të kualifikohet si blerje, pranim apo fshehje e sendeve të përfituara me vepër penale. Sa i përket veprës penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.1 të KPRK-së, ka pretenduar se deklarata e dt.16.12.2019 nuk konsiderohet dokument zyrtar, dhe se asnjëherë kjo deklarata nuk është përdorur si dokument zyrtar, për ndonjë qëllim të caktuar, përfshirë edhe krijimin, ndryshimin apo shuarjen e një raporti juridik-civilë, ndërsa që po ashtu nuk është vërtetuar se nënshkrimi në dokumentin e lartcekur është i të mbrojturës së tij. Andaj, në mungesë të provave, i ka propozuar gjykatës që ndaj të akuzuarës M.B të nxirret aktgjykim lirues. Në seancën e rishqyrtimit gjyqësor ka shtuar se nga raporti i ekspertizës nga AKF, kjo ekspertizë bazohet në mostra të marra në mënyrë të kundërligjshme, të cilat duhet të veçohen nga shkresat e lëndës, sepse nuk është bërë identifikimi i dhënësit të këtyre mostrave të nënshkrimeve, po ashtu mungon nënshkrimi i prokurorit me rastin e marrjes së këtyre nënshkrimeve nga B.M.

E akuzuara M.B në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se e mbështesë në tërësi fjalën përfundimtare të dhënë nga mbrojtësi im.

Ndërsa në mbrojtjen e saj e akuzuara M... Berisha ka deklaruar se mbesë në tërësi pranë deklarimit të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të kaluar të datës 02.02.2023 ku kishte deklaruar se shfrytëzon të drejtën për të mos u deklaruar në këtë çështje penale, pasi që në mbrojtjen e paraqitur në shqyrtim gjyqësor e ka shfrytëzuar drejtën për tu deklaruar pjesërisht dhe atë vetëm në pyetjet e paraqitura nga mbrojtësi i saj, me ç’rast ka deklaruar se punon në ..., që nga viti 2018 dhe sa i përket veprimeve inkriminuese që ngarkohet në aktakuzë, ka theksuar se pas shume diskutimeve me familjar, koleg, miq, rastësisht është takuar me A.in, nga i cili ka marr ofertë për blerjen e një veture nga një shok i tij tani dëshmitari B.M, dhe pasi ka marr kredi, ka vendosur blerjen e të njëjtës, ende edhe sot paguan këste e kësaj kredie, për çka ka dorëzuar kontratën e bankës dhe po ashtu kontratën noteriale për blerjen e veturës, të cilën edhe e ka futur në posedim dhe shfrytëzuar për periudhën pothuajse 2 vite, dhe nga blerja e veturës asnjëherë nuk është

takuar dhe nuk ka pasur asnjë problem me B.M si shitës i automjetit. Në deklarata e dhëna në procedure paraprake, përkatësisht në deklaratën e dhënë në Polici me dt.01.03.2021, ka deklaruar se në vitin 2019 ka shprehur dëshirë që të blej veturë dhe për këtë ka biseduar me A.K, i cili ka propozuar që ta blej veturën e shokut të tij B.M, janë takuar në restorantin “Gizzi” në Grand Store, ku prezent ka qenë B.i, A.i dhe L.i, me ç’rast janë akorduar për çmimin prej 17.000.00 euro, pastaj ka shtuar se ka filluar të interesohet për marrjen e kredisë për pagimin e çmimit të veturës, ashtu që ka marr kredi shumë prej 17.000.00 euro, mirëpo që vetëm 7.000 euro ka mundur të i transferoj në emër të pagimit të çmimit të veturës, ndërsa që pjesën tjetër është dashur të i tërheq për investim, ashtu që nga shumë 10.000 euro e tërhequr, ka paguar dënimet për kundërvajtje në vlerë prej 600 euro, ndërsa që pjesën tjetër ja ka dhënë B.it në një zarf, aty prezent përveç B.it ka qenë edhe L.K, A.K dhe H., i cili ka qenë në një distancë me të largët. Noteri i ka pohuar se kontrata mund të bëhet vetëm mbështetur në transaksion bankar, ndërsa që për pjesën kesh të parave të dhëna, ka hartuar një deklaratë me të dhënat e B.it dhe është nënshkruar nga i njëjti. Here në e fundit që është takuar me B.M ka qenë data 26.02.2021, derisa ka qenë në restorant me L.K dhe një kolege të punës, kur ka ardhur B., dhe i është drejtuar me fjalët “mu me keni marr në qafë, kerrin e blejtë e unë qelesin rezervë e kam dhe kur të dua mund t’ia marr kerrin kësaj zoje por A. nuk po më lajmërohet”, pastaj, ai dhe L. janë ulur në një tavolinë tjetër dhe kanë biseduar, dhe pas përfundimit të bisedës i akuzuari L. është kthyer në tavolinë dhe i ka pohuar se nuk është asgjë për tu shqetësuar se ka në mes A.it dhe B.it, pasi që këtij të fundit i ka burgje. Po ashtu në deklaratën e dhënë në Prokurori me dt.10.10.2022, ngjashëm ka deklaruar lidhur me takimet me B.M duke theksuar se janë takuar në restorantin “Gizi” me ndërmjetësimin e A.K i cili edhe ja ka propozuar veturën B.it për ta blerë, është biseduar vetëm për veturë, çmimi fillimisht i është thënë 19.000.00 euro, në takimin e dytë në po të njëjtin vend, kanë ra dakord për çmimin prej 16.000.00 euro, në këto takime prezentë ka qenë edhe A.i dhe L.i, se ka marr kredi në shumë prej 17.000.000, nga të cilat 7.000 euro i janë transferuar përmes bankës B.i, ndërsa që 8400 euro i janë dhënë kesh në zyrën e noterit, në momentin e lidhjes së Kontratës së shitblerjes së veturës. Në fjalën përfundimtar ka deklaruar se e përkrah fjalën përfundimtare të mbrojtësit të saj.

Mbrojtësi i të akuzuarës F.D, av.Arlind Jupolli, në seancën e caktuar për dhënien e fjalës përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar dhe të elaboruar gojarisht, ka theksuar se nga provat e administruara nuk është vërtetuar se e mbrojtura e tij ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, duke shtuar se procedura e prokurimit është zhvilluar në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurim publik, çka vërtetohet edhe me mungesën e ankesave eventuale nga palat që kanë mund të jenë të pakënaqura, pastaj, nuk është vërtetuar se çfarë dëmi është shkaktuar dhe për kënd është siguruar përfitimi i kundërligjshëm, si elemente të veprës penale për të cilën akuzohet e mbrojtura e tij. Po ashtu ka shtuar se pasi që e mbrojtura e tij, ka kërkuar sqarim nga Agjencia Qendrore e Prokurimit si të veprohet meqenëse produktet e kërkuara nuk kanë mundur të sigurohen nga operatori ekonomik me të cilën kanë pasur kontratë, dhe pasi që Agjencia Qendrore e Prokurimit i ka dhënë përgjigje pozitive, ka vazhduar me procedurën e prokurimit publik. Në këtë rrethana të vërtetuar, sipas të cilave e akuzuara F.D ka vepruar në pajtim të plot me ligjin për prokurim Publik, ka kërkuar nga gjykata që ndaj të njëjtës të nxjerr aktgjykim lirues, pas që nuk është vërtetuar se ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Në seancën e rishqyrtimit gjyqësor ka shtuar se me nxjerrjen e ekspertizës së prokurimit publik,

dhe m dëgjimin e ekspertës u vërtetua se e mbrojtura ime ka vepruar konform dispozitave ligjore dhe në bazë të autorizimeve të saj.

E akuzuara F.D në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se e mbështesë në tërësi fjalën përfundimtare të dhënë nga mbrojtësi im.

Ndërsa në mbrojtjen e saj e akuzuari F.D ka deklaruar se mbesë në tërësi pranë deklaramit të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të kaluar të datës 02.02.2023 ku kishte deklaruar se shfrytëzon të drejtën për të mos u deklaruar në këtë çështje penale, pasi që në mbrojtjen e paraqitur në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se pas konsultimit me mbrojtësin, ka vendosur ta shfrytëzoj të drejtën e saj që të mos deklarohet duke theksuar njëherit se nuk qëndron pranë deklaratës së dhënë në Prokurori pasi që e njëjta është dhënë në presion të kushteve dhe situatës. Në deklaratën e dhënë në procedurë paraprake, përkatësisht në deklaratën e dhënë në Prokurori, ka deklaruar se është udhëheqëse e divizionit të prokurimit në ..., sa i përket kontratës “Furnizim me mobileje ekskluzive për kabinetin e ... të Republikës së Kosovës me nr.identifikues PSH250-021-001-136” ka theksuar se në fund të vitit 2020, e ka ftuar drejtori L.K në zyrën e tij, dhe i ka thënë se po bëhet këshilli i ri, kështu që kryesuesit të ri duhet me ia mobileje zyrën, përkatësisht pesë zyrat të cilat ishin kërkuar nga i njëjti. Me këtë rast, i ka shpjeguar të njëjtit se kanë një kontratë për furnizim me mobilie me operatorin “M...”, sipas planit të prokurimit, dhe përves kësaj edhe Agjencia Qendrore e Prokurimit e cila i ka disa kontrata të centralizuara për momentin, të cilat sipas planit të prokurimit, në mungesë të kontratave, në mënyrë automatike janë të obliguar t’u bashkëngjiten, përkatësisht të furnizohen me kontratat e siguruara nga AQP-ja. Ka shtuar se fillimisht e ka dërguar një kërkesë në AQP, të cilët i ka njoftuar se po kërkojnë mobilie ekskluzive, të cilat nuk janë në kontrata që veç i kanë të kontraktuara, dhe nga AQP kanë marrë përgjigje se munden me vazhdu me tenderim për sigurimin e këtyre mobileve, me atë rast, përsëris i është kërkuar nga Kryesuesi që të mobilohen zyrat e tij, ndërsa që në at rast ka shkuar te drejtori, ku është njoftuar se ishin përgatitur specifikat teknike bashkë me kërkesën e njësisë kërkuese, që ka qenë zyra e kryesuesit, konkretisht zyrtarja ligjore L.D, e cila ka përpiluar kërkesën për ato mobilie. Me dt.27.01.2021, është bërë njoftimi për kontratë në sistemin I-prokurim, domethënë është bërë shpallja publike për ofertomë, ku operatorë ekonomik kanë qenë të obliguar që brenda pesë ditëve të ofertojnë, pastaj me dt.01.02.2021 është bërë hapja e ofertave, kanë ofertuar tre operatorë, “G...”, “M...” dhe një operator tjetër nga Shqipëria, i cili nuk i ka plotësuar kushtet. Ka theksuar se në atë kohë drejtori e ka pyetur se kur do të vinë mobiliet, e pandehura i ka treguar që si të kryhen procedurat, të nënshkruhet kontrata dhe pastaj vine mobiliet, mirëpo përsëri të nesërmen e ka ftuar drejtori në zyre, dhe i ka thënë që tu thotë, që t’i sjellin tri fotele dhe një tavolinë për zyrën e kryesuesit; kështu që pandehura si rrjedhojë e presionit nga Drejtori e ka telefonuar kompaninë “S...”, e cila nuk ka marrë pjesë fare në tender, kompania i ka sjelle mobiliet e lartcekura pa faturë, para nënshkrimit të kontratës për furnizim me mobilie me operatorin “G...”.Ka shtuar se kur drejtori e ka kuptuar se nuk është operatori “S...” pjesëmarrës në tender, i ka thënë nëse mundet të bisedojë me fituesin e tenderit, në atë rast “G...”, që ata të shkojnë t’i marrin ato mobilie tek kompania “S...”. E ka thirrë në zyre përfaqësuesin e operatorit “G...”, Bajramin, i ka treguar se drejtori i ka bërë presion që disa nga mobiliet t’i porosisin në kompaninë “S...”. Gjithashtu e ka pyetur nëse munden që ata t’i marrin ato mobilie në “S...” dhe t’i sjellin në emrin e tyre, dhe ai është pajtuar. Pastaj e pandehura e ka

dërguar Bajramin në zyrën e drejtorit, i cili kishte qenë në takim, duke i thënë të shkojnë në zyrën e kryesuesit. Ata kanë shkuar tek zyra e kryesuesit, i cili ka qenë shumë i paqartë në kërkesat e tij, vetëm është ankuar se nuk ka zyre për t'i mbajtur takimet; por qe nuk e ka obliguar Bajramin të veprojë, sa i përket atyre mobilieve. Kjo bisedë me përfaqësuesin e operatorit "G...", Bajramin, është bërë pasi është kryer vlerësimi i operatorëve ekonomik, por pa u përcaktuar fituesi ende, sepse aty përfshihet edhe periudha e ankesave; kjo ka ndodh për afërsisht me datën, 04.03.2021, dhe sipas saj në njëfarë mënyrë, është prejudikuar fituesi, duke qenë se në rast ankese ka mund të fitoj edhe ndonjë operator tjetër pjesëmarrës në procedurën e tenderimit. Në fjalën përfundimtar ka deklaruar se e përkrah fjalën përfundimtare të mbrojtësit të saj.

Pas vlerësimit të provave të proceduara një nga një dhe të gjitha së bashku, konform nenit 360 par.2 të KPPRK-së, ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike e ka vërtetuar nga të gjitha provat personale dhe materiale që janë proceduar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, dhe atë nga dëshmitari B.M, dëshmitaret A.M, B.P, B.B, S.B, E.SH, L.D, F.K, D.B, I.S, Z.K.D, I.H, V.C, F.L, F.S dhe B.L, F.A , A.Z dhe Ekspertja e prokurimit publik Blerina Shamolli si dhe provave materiale: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore ne Prishtinë me numër PKR.712/2015 i dt.28.12.2018; Aktgjykimi i Gjykatës se Apelit me numër PKR me numër. 134/19 i dt.05.04.2019; Përgjigje në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, me nr.KMLP.nr.128/19 edt.17.06.2019; Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, me nr.Pml.nr.178/2019 i dt.02.07.2019; Kërkesa për interpretim të aktgjykimit, drejtuar Gjykatës Supreme e dt.19.09.2019; Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit e dt.08.12.2020; Kontrata për shitblerjen e veturës LRP:16008/12, Ref:3464/19; Deklarata e dt.16.12.2019; Raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, me nr.AKF/2021-0908/2021-850 e dt.21.04.2021; Analiza për "Covid 19" dhe Memorandumi i IPKSHP-se; Sistemi për menaxhimin e kufirit (Hyrje-dalje ne vendkalimet kufitare); Videot e emërtuara si CD-A1, A2 dhe A3; Kallëzimi penal i ushtruar nga B.M i dorëzuar ne emër te tij ndaj A.Kt; Bisedat e Whatsapp (në mes te pandehurit L.K me te pandehurit A.K, me L.K si dhe B.I); Biseda në Viber të pandehurit A.K me B.M; Biseda në Messenger në mes të pandehurit A.K me B.M si dhe biseda e B.M me A.M; Provat e furnizimet me mobilie(dosja e tenderit); Kërkesën për shlyerjen e detyrimeve dt.08.03.2021; Faturën për pagese te datës 03.03.2021; Raportin për pranim te shërbimeve nga menaxheri i kontratës dt.08.03.2021; Raportin e komisioni mbi pranimin e mallrave dt.05.03.2021; Ndryshimi dhe plotësimi i vendimit nr.pro.DPSKPK -83/2021 e dt.05.03.2021; urdhër blerjet e datës 16.02.2021; kërkesën për mallra dhe shërbime me numër të kërkesë 2021-39 26; Kërkesën për zotim për blerje te datës 15.02.2021; Kërkesën e brendshme për zotim dt.15.02.202; kontratën e lidhur me operatorin ekonomik dt.16.02.2021; Vendimin e KPK-se, me numër pro DPSKPK/71/2021 dt 24.02.2021; Bisedat në viber mes te pandehurit L.K me A., baci X., . dhe Pozhegu Brother"; Raporti i ekspertit financiare për llogarite bankare për të pandehurit L.K për periudhën 2008-2021, Raporti informues i policisë për zbulimin e të dhënave financiare, urdhërpagesa kombëtare e Pro Credit Bank, pagesa pe shitjen e banesës (përgjigja ne kërkesë nga Agjencia kundër korrupsionit); aneks kontrata për ndarjen njësave ndërtimore nga ndërtimi i përbashkët dhe kontrata për ndërtim te përbashkët; Përgjigja e Drejtorisë Kadastrale te Komunës se Prishtinës; Përgjigja e Odes se Noterëve te Kosovës,

“autorizimi për përfaqësim në emër të S.K” dhe komunikimi i te pandehurit L. përmes email me mikun e tij A.Z; Marrëveshja mbi kredinë për persona Fizik nr.261060 e dt.12.12.2019; urdhër pagesa kombëtare ref.nr.940273 e dt.16.12.2019, Konfirmimin bankar i dt.05.10.2021 i lëshuar nga Banka “TEB”; urdhër pagesa kombëtare ref.nr.941083 e dt.18.12.2019, dhe fletëpagesat e dënimeve të gjobave në ekspertizën e prokurimit me numër 250-21-236-1-3-6 të datës 12.02.2024 .

Dëshmitari bashkëpunues B.M në seancën e rishqyrtimit gjyqësor të datës 09.01.2024 ka deklaruar se mbetëm në tërësi pranë deklarimit të dhënë në shqyrtimin e kaluar, ku kishte deklaruar se në muajin Mars apo Prill të vitit 2019, përmes shokëve të përbashkët, emrat e të cilëve nuk i ka përmendur, është takuar me A.K në lokalin “S...” i cili është prezantuar si punëtor në prokurorin e shtetit, në at rast kanë biseduar për lëndën e tij, ja ka dhënë të gjitha të dhënat për lëndën që ka pasur në Gjykatën Supreme dhe i njëjti i ka thënë se do e njofton pas 2 apo 3 ditëve, dhe se atë lëndë do ta kthej në rigjykim. Pas 2-3 dite ka shkuar prapë në lokalin “S...”, ka takuar shokët e A., përmes të cilëve e ka njoftuar A.in se është duke e kërkuar, fillimisht kanë biseduar në whatsapp, pastaj janë takuar fizikisht dhe i ka pohuar se lënda është kthyer në rigjykim-rishqyrtim, dhe për këtë i ka ndihmuar H.M, L.K dhe babai i avokatit M.Q, pastaj ka biseduar me avokatin e tij, që i ka konfirmuar se dënimin me burgim 7 muaj i’ka kanë rritur në 1 vit, ndërsa dënimi me burgim 3 vjet është kthyer në rivendosje, lidhur me këtë rrethanë është ballafaquar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës PML 178/2019 që rezulton të jetë i dt.02.07.2019, ku ka deklaruar se “kallxova në fund unë kam mbjell lajthia në at kohë pasi që e pata fituar një grand dhe nuk e di kurrë kohën e saktë”. Ka shtuar se e ka lutur A.in a po donë pare pasi që kishte 5 mijë euro me vete, mirëpo nuk ka pranuar se ka thënë këtë punë ta kam kryer painteres, ndërsa që ja ka dhënë një armë që ka pasur me vete, dhe A.i i ka thënë se i duhet një shpi me qira, dhe nga aty s’bashku edhe me një shok me emrin F., kanë shkuar të shtëpia e këtij të fundit, e cila ka qenë përballë Grand Store dhe F.a ju ka thënë që 400 euro po ta jep për ty si B. dhe dëshmitari ia ka paguar A.it për 3 muaj qiranë, pasi që A.it i ka pëlqyer shtëpia, ndërsa që për një vit i ka paguar shumë prej 4800 euro, mirëpo që para A.it i ka dhënë disa herë dhe atë për herën e parë i ka dhënë 2.000 euro, mbas një ose dy dite ja ka kërkuar përsëri 3000 euro për me ble sende për shpi ku është vendos tek F.a, si dhe 2000 euro për djalë të shefit për me ia pagu shkollën në Shqipëri ku i ka pa vet mesazhet tu fol me L.in, ku L.i i ka thënë lypja B.it, mirëpo fillimisht ka pohuar se nuk ka dëshmi për këto para të dhëna, pastaj ka deklaruar se kam dëshmi pasi që ka ardhur i ka marr paret dhe ka marr Kreditë. Ka shtuar se në dalje të parkingut të banesës së tij në Dragodan ka takuar për herë të parë L.Kn i cili ka qenë bashkë me A.in, të cilët kanë qenë me veturë zyrtare, dhe kanë biseduar për veturën e dëshmitari të tipit “VË T-roc”, e cila ka pasur vlerë rreth dikund 37000 ose 38000 euro, dhe për këtë arsyeje pra veturën e tipit “VË T-roc”, edhe janë takuar në Grand Store, në “Gizzi”, ku prezentë kanë A.i, L.i dhe M... të cilën aty e ka takuar për herë të parë, në përfundim të atij takimi M., i ka dhënë çelësat, ndërsa që A.it i ka dhënë shumën prej 15000 euro, me arsyetimin se i vyne për një transaksion, ndërsa që më vonë gjatë dëshmisë së dhënë ka deklaruar se në at moment ja ka dhënë 5.000 euro, dhe për çdo dite ka shkuar ka marr ne lokal. Ka pohuar se veturën ia ka dhënë që ia ka kthyer lëndën në rigjykim, dhe për ta mbyllur at punë, meqenëse i është premtuar kjo nga A.i dhe L.i, mirëpo për këtë çështje një ose dy ditë pas këtij takimi, A.it përsëri i ka dhënë shumën prej 1400 euro, si dhe ka ndodhur formalizmi i shitblerjes së veturës, në zyrën noteriale,

ku prezent ka qenë L.K dhe M.B dhe H. (fjala është për dëshmitarin I.S), i cili është kthyer nga rruga meqenëse vetura ka qenë në emër të tij. Në këtë rast është ballafaquar me kontratën për shitblerjen e bere tek noteri Safedin Balaj, e datës 16.12.2019, me numër LRP.16008/2019 REF 3464/19, dhe autorizimin noterial te përpiluar nga noteri Safedin Blakaj me numër LRP 15995/2019 te datës 16.12.2019, pas të cilit ballafaqim ka deklaruar se kur ka shkuar të gjitha i ka gjetur të gatshme, këtë autorizim nuk e ka pare kurrë, aty çka ka ba L.i e din, ai qysh i ka ndreq, nënshkrimi në kontratë nuk është i tij, nuk ka pasur arsye me nënshkruar se vetura nuk është kanë në emrin tij, të noteri ka shkuar për ta dërguar H.n, se nuk ka pasur autorizim për shitje te këtij automjetit nga firma H., mirëpo që i detyrohet për borxhin prej 36.000.00 euro, në emër të çmimit të kësaj veture. Ka deklaruar se nuk ka pranuar asnjë shumë të hollave nga M..., duke qenë se nuk ka qene pronar i veturës, nuk ka pasur të drejtë me ja transferu ato para, parat kanë qenë të tij, të cilat paraprakisht ja kishte dhënë A.it, dhe përsëri pas përfundimit të transaksionit bankar 7 apo 8 ditë pas lidhjes së kontratës, ato para të transferuara i ka marr A.i. Pasi këtij pohimi është ballafaquar me konstatimin në kontratën noteriale dhe autorizimin noterial për shitblerjen e automjetit, ku shprehimisht ceket që paratë duhet te kalojnë ne llogarinë të B.M, përçak ka deklaruar se kurrë nuk e di se çka kane bërë këta tek noteri, për këta me se miri e din H., L.i dhe M... dhe se gjatë kohës që ka qenë në zyrën e noterit Sefedin Blaka nuk ka nënshkruar ndonjë deklaratë për pranimin e shumës prej 8400 euro. Ka shtuar se me L.in është takuar 3-4 herë, në Dragodan, tek restoranti “Gizzi” dhe njëherë në një kafe në fundjavë, lidhur me problemin që ka shkaktuar djali i tij A.M dhe djali i vëllait Guri, lidhur me një tentim vrasje, ndërsa që në vijim të dëshmisë, ka pohuar se të akuzuarin L. e ka takuar edhe njëherë në një kafiteri afër KPK-së. Sa i përket takimit në fundjavë (sipas dëshmitari lidhet me kohen kur ka ndodh ngjarja e djalit të tij) ka theksuar se është takuar me A.in, A.i ka fol me L.in, dhe pas përfundimit të bisedës i ka thënë se G.M (djali i vëllait të dëshmitarit) me dorëzuar në polici pasi që L.i e ka ndreq punën e nxjerrim pa i ba 48 orë, ka qenë në “Baron” tek Ministria e Arsimit së bashku me A.in dhe i ka thanë a po ma kryeni punën, a thuaj L.it se të erdha tek puna dhe L.i i ka than aman zaman mos ma bir tek puna se shkova unë tek Kryeprokurori, dhe L.i dhe A.i kanë shkuar pasi që i kanë lëshuar kamerën dhe e ka parë “live” L.in duke hyrë në prokurori, ndërsa që i kanë premtuar se G. nuk e lanë në burg pasi që i ishte caktuar paraburgimi 30 ditë, ndërsa i është thënë se A.n duhet me dërgua në Shqipëri derisa ta nxjerrim G., dhe me veturën e L.it të cilën e ka drejtuar A.i, janë nisur nga rrethi autostradës në fshatin Trud, A. ka hyrë në veturë me A.in, ndërsa ai me shokun e tij I.S janë nis me veturën e tij, që i kanë përcjell deri tek tuneli në Shqipëri. Pastaj, pas 10 dite apo dy jave, derisa ka qenë në Shqipëri për ta takuar djalin e tij A.n, përmes telefonit e ka lajmëruar një shok se ndaj tij është lëshuar flete arrest, ka kontaktuar me A.in, i cili i ka thënë se flete arresti nuk i është lëshuar për pune që i ka kryer ai, dhe kanë ra dakord që të shkoj ta marr në kufi, dhe të nesërmen është arrestuar në Prishtinë nga Policia, ka kontaktuar përsëri me A.in, i cili i ka premtuar se do nxjerr si gjithë, mirëpo ka shkuar në vuajtje të dënimit, dhe përmes shokëve i ka qar fjalë që të krye punën e djemve të tij ose të ja kthej shumë e parave që i ka dhënë për të kryer punë. Në këtë drejtim ka pohuar se me qëllim që të pengohet shkuarja në ekzekutim të dënimit, përcka A.i dhe L.i kishin marr para, i kanë dorëzuar do letra në Gjykatë, me “Covid” nuk është infektuar asnjëherë, dhe raportin mjekësor për “Covid” nuk e ka, por sipas tij me si G.është në gjykatë. Ka theksuar se A.it nuk i ka besuar, por ka filluar të i besoj kur ka folur me L.in dhe ka parë edhe SMS që kanë shkëmbyer ndërmjet vetes. Është ballafaquar me deklaratën e dhënë në prokurori ku ka deklaruar se derisa ka qenë

në vuajtje të dënimit në burg të Prishtinës, ka ardhur një person në vizitë i cili ishte familjar i A.it, L.it apo M...s i ka ofruar që të kthej 65000 euro në mënyrë që të tërhiqet nga deklaratat nga ky rast, po ashtu e njëjta situatë i ka ndodhur në burgun e Dyzit, emrat nuk i ka përmendur sepse sipas tij nuk donë me rreziku veten. Ka deklaruar se nuk ka dijeni se prokuroria e shtetit ka pushuar procedurën hetimore ndaj tij dhe si dëshmitar bashkëpunues, nuk ka pasur ndonjë përfitim, është e vërtetë që është liruar me kusht në bazë të kërkesës që e ka bërë vetë. Në deklaratën e dhënë në seancën dëgjimore për shpalljen dëshmitar bashkëpunues me dt.12.02.2021, ka përshkruar takimet me A.Kn, vendin ku janë takuar, kafiterija “Solo” në Prishtinë, faktin se takimin dhe njohjen me A.in ja kishte këshilluar një politikan, të cilit ka refuzuar të ja përmend emrin, mirëpo sipas tij ai i ka thënë se ka biseduar me A.in për rastin e tij, pastaj ka përshkruar natyra e bisedave që dëshmitari ka bërë me A.in, premtimin për të ja kthyer lëndën në rigjykim, duke i thënë që jam duke shkruar me shefin L.Kn dhe për 2-3 orë do ta njoftoj sa çka ka bërë, mirëpo atë ditë nuk i është lajmëruar, po të nesërmen janë takuar në të njëjtin vend dhe e ka njoftuar se lëndën ja ka kthyer në rigjykim. Ka theksuar se revolen të cilën ka pasur me vete, ja ka dhënë A.it sipas kërkesës së tij, ndërsa që shumën prej 5000 euro, të cilën ka shkuar të i marr të një shok, nuk ja ka pranuar, duke i thënë duhet të bisedoj me dikën. A.i ka filluar të ankohet se është në hall për një shtëpi, në at rast aty ka qenë shoku i dëshmitarit F.Q, i cili i ka ofruar shtëpinë e tij për banim kundrejt qirasë së caktuar ku edhe është vendosur A.i, e qiranë ja ka paguar dëshmitari. Ka pohuar se A.i ka vazhduar me kërkimin e shumave të caktuar të parave, 2000 euro njëherë, pastaj 3000 euro, përsëri 2000 euro që i ka thënë janë për djalin e L.it për me dërguar në Shqipëri. Pastaj ka shpjeguar takimet lidhur me shitblerjen e veturës, ku fillimisht janë takuar në Dragodan, me të akuzuarin L., kanë biseduar për veturën, për të cilën ky ju ka thënë se është në gjendje që të ua jap, për të kryer punë, pastaj e ka thirr ndërkohë shokun e tij H.S (Hysu) në telefon dhe i ka thënë se me duhet vetura me ja dhanë A.it dhe L.it për me krye punë në gjykatë, ndërsa që i njëjti i ka thënë jepja me dy duart, nuk ka problem. Pas dy apo 3 dite janë takuar në restorantin “Gizzi” kanë qenë prezent A.i, L.i dhe M..., me atë rast M. ja ka dhënë çelësat e veturës se tipit “Troca” me vlerë 30.000.00 euro, për të vazhduar me pohimin se A.i përsëri i ka kërkuar para në shumë 30.000.00 euro, mirëpo ja ka dhënë 5.000 euro, 5000 ja ka dhënë djali A., pastaj 1500 apo 2000 euro ja ka dhënë për djalin e shefit dhe i ka par mesazhet që L.i ja ka dërguar A.it ku i ka kërkuar para nga dëshmitari, si dhe përsëri i ka dhënë 5000 euro djemtë e dëshmitarit A. ose A.. Ka shtuar se vetura ka qenë në emër të H.St, dhe për tu bërë shitblerja me letra është dashur të jetë ai prezent si pronar i veturës, përçka ai ka ardhur te noteri, ku prezent ka qenë edhe L.i e M.... A.i i ka kërkuar që me ja dhanë 14.000 ose 15.000 euro, siç edhe ka vepruar, të cilën shumë në llogarinë e tij e ka bartur L.i apo A.i nga xhirollogaritë e tyre personale, të cilën shumë përsëri ja ka dhënë A., ku prezent ka qenë edhe L.i mirëpo që nuk ka qëndruar, dhe në momentin e kthimit të parave ka qenë vetëm me A.in, mirëpo ai i ka telefoni L.it se i mori parat. Ka theksuar se me L.in është takuar pesë apo gjashtë herë, me M. tri apo katër herë dhe vetëm për punën e veturës, ndërsa që me A.in është takuar çdo ditë. Po ashtu ka përshkruar edhe rastin e djalit të tij A.M, rreth në mesit të vitit 2020, premtimin e A.it për të intervenuar, përmes të akuzuarit L., dërgimin për në Shqipëri të djalit të tij A.t rrethana këto që i ka përshkruar ngjashëm si në dëshminë e dhënë në shqyrtim gjyqësor, duke shtuar që lidhur me këtë rast, L.i gjatë një takim që kanë pasur në restorantin “Gizi”, ku prezent ka qenë edhe A.i dhe M..., ka pohuar të njëjtit se sa i përket punës së dënimit, prej 3 vitesh e 7 muaj, “nuk do të mbash burg as një ditë” dhe se si i kanë ndihmuar për të ja kthyer lëndën në rigjykim, po ashtu

kanë me ja heq edhe dënimin me burgim. Në deklaratën e dhënë në Prokurori me dt.26.03.2021, ka deklaruar se deklarata në të cilën konstatohet se nga M... ka marr shumë kesh prej 8400 euro nuk është nënshkruar nga ana e tij, mirëpo që A.it ja ka dhënë 15.000.00 euro, pastaj kanë shkuar të noteri dhe është nënshkruar deklarata nga H. dhe M... ku prezent ka qenë edhe L.i. Shumën prej 7.000 euro e ka pranuar në llogarinë e tij bankare, të cilën pas disa ditësh me insistimin e A.it, ja ka dhënë të njëjtit, në një vend që nuk i kujtohet. Po ashtu ka përshkruar edhe rastin e djalit të tij A.M, duke theksuar se para arratisjes së djalit të tij, është takuar me A.in në një restorant në lagjen Qëndresa dhe derisa kanë qenë duke qëndruar A.i e ka thirr L.in, dhe e kanë pyetur se a bën ta dërgojnë në Shqipëri djalin e dëshmitarit A.n me veturë zyrtare, përgjigja e ti ka qenë po mund ta dërgoni, derisa t'ia dreqi punën me kryeprokurorin.

Sa i përket rrethanës së deklaruar nga dëshmitari bashkëpunues B.M që lidhet me vërtetimin e faktit se i akuzuari A. në muajin shtator të vitit 2020, në cilësinë e personave zyrtar, duke e shfrytëzuar veturën zyrtare të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, i kanë mundësuar të dyshuarit A.M që të arratiset nga territori i Republikës së Kosovës, për në Shqipëri, kjo rrethanë është pohuar edhe nga dëshmitari A.M, e po ashtu janë administruar edhe prova materiale, gjykata këtë pjesë të deklarimit nuk e ka vlerësuar pasi që ka të bëjë me të akuzuarin A.K për të cilin është veçuar procedura penale. Ndërsa që sa i përket pjesës tjetër të dëshmisë së këtij dëshmitari, gjykata vlerëson se e njëjta karakterizohet nga natyrë e tillë e kontradiktave lidhur me rrethana të njëjta ka bërë pohime krejt të ndryshme, pohime këto që po ashtu janë në kundërshtim edhe me provat materiale, saktësia dhe besueshmëria e të cilave prova është e pakundërshtueshme. Dëshmitari ka pohuar se me të akuzuarin A. është takuar në muajin mars apo prill të vitit 2019, dhe sipas tij i njëjti i ka pohuar se pas dy apo tri ditëve do ta njoftoj për lëndën e cila ishte duke u trajtuar në Gjykatën Supreme dhe ashtu ka vepruar, duke u komunikuar se lënda i është kthyer në rivendosje, mirëpo siç rezulton aktgjykimi i Gjykatës Supreme PML 178/2019, Gjykata në këtë rast ka vendosur në muajin korrik 2019, pra si ka mundur i akuzuari A. ta njoftoj në muajin Mars-Prill për një vendim që rezulton të jetë marr në muajin Korrik, dëshmitari këtë kontradiktë, e ka shpjeguar duke pohuar se "...në fund unë kam mbjell lajthia në at kohe pasi që e pata fitua një grand dhe nuk e di kurrë kohën e saktë", mirëpo kontradikta lidhur me këtë rrethanë nga ana e dëshmitarit thellohet ende, pasi që në deklaratën e dhënë në seancën dëgjimore për shpalljen dëshmitar bashkëpunues me dt.12.02.2021, ka pohuar se në takimin e parë në kafiterin "Solo" në Prishtinë, A.i ka qenë duke biseduar me Shefin L.K, kur i ka premtuar se për 2-3 orë do ta njoftoj sa çka ka bërë lidhur me lëndën, ndërsa që të nesërmen e ka njoftuar se lëndën ja ka kthyer në rigjykim, ndërsa që në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar pas dy apo tri dite. Më tutje, në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se me at rast e ka lutur A.in a po donë pare pasi që kishte 5 mijë euro me vete, mirëpo nuk ka pranuar se ka thënë këtë punë ta kam kryer painteres, ndërsa që në deklaratën e dhënë në seancën dëgjimore për shpalljen dëshmitar bashkëpunues me dt.12.02.2021, për të njëjtën rrethanë ka pohuar se shumën prej 5000 euro, të cilën ka shkuar të i marr te një shok, nuk ja ka pranuar derisa të bisedoj me dikën, duke ndryshuar kështu pohimin e tij nga kryerja "painteres e punës" siç i ka thënë A.i, në nevojën që për pranimin e asaj shumë duhet të flas me një person të tretë. Natyra kontradiktore e deklaratave të këtij dëshmitari, ka vazhduar edhe lidhur me rrethana tjera, ashtu që pasi që ka deklaruar se në rastin e veturës, A.it i ka dhënë shumën prej 15,000.00 euro, nga e cila shumen prej 7000 euro e cila rezulton në kontratë e ka transferuar përmes bankës, ku herë ka deklaruar se parat nuk janë



paguar në xhirollogarinë e tij, e here ka deklaruar të kundërtën, mirëpo që duke i mbetur besnik pretendimit se nuk ka nënshkruar kurrfarë kontrate për shitjen e veturës, ndërsa edhe pas ballafaqimit me kontratën për shitblerjen e datës 16.12.2019, me numër LRP.16008/2019 REF 3464/19, dhe autorizimin noterial me numër LRP 15995/2019 të datës 16.12.2019, ka vazhduar të deklaroj se kur ka shkuar të gjitha i ka gjetur të gatshme, këtë autorizim nuk e ka pare kurrë, aty çka ka ba L.i e din ai qysh i ka ndreq, duke mohuar se nënshkrimi në kontratë është i tij, anipse nga kontrata vërtetohet pakontestueshme se shitësi dhe nënshkrues figuron pikërisht ky dëshmitar, në bazë të autorizimit për përfaqësim, mirëpo dëshmitari edhe lidhur me vetë shumën parave ka qenë në kontradikta me vetveten, pasi që në deklaratën e dhënë në seancën dëgjimore për shpalljen dëshmitar bashkëpunues me dt.12.02.2021, ka pohuar se në xhirollogarinë e tij janë bartur 14000 ose 15000 euro, të cilat ja kishte dhënë A.it me herët, dhe tani të njëjtën shumë përsëri ja ka dhënë A.it, ku prezent ka qenë edhe L.i, mirëpo që në deklaratën e dhënë në Prokurori me dt.26.03.2021, nuk e ka përmendur fare pranin e L.it dhe aq me pak që të ketë parë kur i ka shkruar A.i L.it për shumën e pranuar, mirëpo përves kësaj rrethane, ndryshe nga sa thotë ky dëshmitar, se parat ja ka dhënë për të i deponuar në llogarinë e të akuzuarës M... dhe pastaj transferimin në llogarinë e tij (edhe pse edhe përket rrethanë, here thotë në llogarinë e tij e here në llogari tjetër), nuk rezulton e vërtetuar kurrfarë deponimi mjeteve në xhirollogarinë e të akuzuarës M..., në kohën kur pretendon ky dëshmitar. Pastaj, dëshmitari ka deklaruar se nuk ja ka dhënë çelësin e dytë të veturës të akuzuarës M... sepse nuk i ka besuar të akuzuarit A.it, gjithmonë duke pretenduar se veturën e kishte dhënë për të kryer punë, me çmim fiktiv të blerjes, mirëpo një pohim i tillë i këtij dëshmitari është në kundërshtim me dëshminë e dëshmitarit H.S i cili ka deklaruar se çelësin e veturës e ka poseduar ai, të cilin çelës siç ka theksuar edhe vetë, nuk e ka ditur që e ka poseduar, meqenëse ka qenë në xhepin e një rrobe të cilën nuk e kishte përdorur një kohë të gjatë. Po ashtu, ndryshe nga dëshmitari B. i cili ka deklaruar se kur e ka thirr dëshmitarin H., për të shkuar tek zyra noteriale, i ka treguar se si e ka dhënë veturën, pra mendohet për të kryer punë në gjykatë, ndërsa që dëshmitari H.ka deklaruar se B.i nuk i ka treguar arsyen pse i nevojitet një autorizim apo kontratë e tillë. Është e qartë se në rastin e këtij dëshmitari, është vështirë të gjesh ndonjë moment kur për rrethana të njëjta të ketë dhënë përgjigje të njëjtë. Për këto arsye, gjykata dëshminë e këtij dëshmitari në pjesën kryesore të saj e vlerëson se e njëjta nuk mbështetet dhe me provat tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor

Gjykata në rishqyrtimin gjyqësor të datës 09.01.2024 me propozimin dhe pëlqimin e palëve ka lexuar dëshminë e dëshmitarit A.M, të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të kaluar, ku kishte deklaruar se mbetet pran deklaratës të dhënë në prokurori me datën 04.03.2021, duke shtuar se e njëhë të akuzuarin A.Kn përmes babait të tij B.M dhe i njëjti i është prezantuar si Prokuror, rreth dy vite më parë dhe me të njëjtin është takuar 3-4 here ose 4-5 here, dhe arsyeja e takimit ka qenë dhënia e parave si dhe disa dokumenteve për me ja shlye babit B.M gjykimin. Arsyeja e dhënies ka qenë me ja heq burgun babait të tij, përmes ndihmës së një personi që ka njohur si shef, që atëherë nuk ja ka ditë emrin e tani po, është fjala për të akuzuarin L., dhe se ai personalisht A.it ja ka dhënë njëherë 5.000 euro, pastaj 5.500 euro, edhe njëherë kur e ka kaluar kufirin 2-3 mije, ndërsa që në tërësi me veturë dhe me të gjitha, si familje i kanë dhënë 65.000.00 euro, shumë të cilën e kanë dhënë nga kredia e marr në shumë prej 75.000.00 euro për bujqësi. Ka theksuar se parat, A.i ka shkuar i ka marr në lokalit e tyre dhe është larguar, përveç rastit kur i ka marr letrat e babit për me ja shty gjykimin, ka qëndruar më gjatë, pasi që i kanë kontrollua

letrat bashke me A.in. Ka shtuar se shumën prej 2 apo 3 mije euro ja keni dhëna A.it në Shqipëri pas kalimit të kufirit, kjo pasi që dëshmitari ka qenë në kërkim prej Policisë së Kosovës për veprën penale Vrasje të rënd në tentativë, dhe prej Kosovës në Shqipëri është larguar me veturën zyrtare të cilën e ka drejtuar A.K në urdhrin e L.Kt, ashtu që janë takuar tek rrethi i autobanit në Trudë, dëshmitari ka dalur prej veturës ku ka qenë me babain e tij dhe është futur në veturën Audi, në at veturë ka qenë edhe gruaja dhe djali i A.it, dhe kanë filluar të lëvizin, gjithë kohën dritat rotative i kanë pasur të ndezura, janë ndalur në hyrje të autostradës në Malishevë, ka ardhur një person me emrin G. apo G.K, me një veturë me golf 5 sa i kujtohet, ngjyre e bardhë, dhe u taku me A.in edhe ja ka dhënë një karteletë, ajo karteletë u kanë e Prokurorisë Themelore në Prizren, dhe kanë vazhduar në drejtim të kufirit në Vernic, kur kanë arritur në kufij, gruaja e A.it i ka dhënë një maske të “Covidit” për ta vendosur në fytyrë, dhe pastaj në momentin e kalimit të kufirit A.i e ka marrur një letër të kuqe e ka pasur tek xhami i atij kerrit, ka lexuar Prokuroria në atë letër, ua ka treguar policëve në kufi, dhe të njëjtit i kanë lejuar të vazhdojnë pa i kontrolluar, e që në këtë moment edhe ka bërë një video incizim ku dëgjohet zëri i A.i dhe vërehen dritat rotative. Ka vazhduar duke përshkruar se pas kalimit të kufirit, janë ndalur, ka ardhur babi i dëshmitarit me një shok të tij, i cili i ka dhënë para A.it, dhe në momentin që ka ardhur gruaja e dëshmitarit, kanë vazhduar me rrugëtim ashtu që gruaja e A.it e ka vozitur veturën e prokurorisë përpara, ndërsa që A.i e ka vozitur makinën dëshmitarit, dhe në at veturë ka qenë dëshmitari, gruaja dhe djali i tij, janë ndalur në Lezhe tek miqtë e A.it dhe pastaj kanë vazhduar për në Durrës ku edhe janë ndarë. Në deklaratën e dhënë në procedurën paraprake, përkatësisht në deklaratën në Prokurori me dt.04.03.2021, ngjashëm ka deklaruar, sa përket takimeve me të akuzuarin A., parave që i ka dhënë të njëjtit, arsyeja që i janë dhënë, pastaj, udhëtimin për në Shqipëri, mënyrën e udhëtimit të me të akuzuarin A. dhe rrethana tjera të përshkuara edhe në dëshminë e dhënë në shqyrtim gjyqësor.

Gjykata lidhur me dëshminë e këtij dëshmitari, sa i përket, rrethanave që lidhen me transportimin e tij për në Republikën e Shqipërisë nga i akuzuari A.K me veturë zyrtare, për të ju shmangur arrestimit nga organet ligj-zbatuese në Republikën e Kosovës, për shkak të veprave penale që dyshohej se ishin kryer nga i njëjti, siç është hyrjet-daljet në vendkalime kufitare në kohën kur ky dëshmitar ka dëshmuar se është transportuar për në Republikën e Shqipërisë, faktin se gjatë kalimit në pikën kufitare, nuk janë kontrolluar, çka është në përputhje me faktin se vërtetë në sistemin e të dhënave nuk figuron se i akuzuari A. me veturën zyrtare ka hyrë në Republikën e Shqipërisë, mirëpo vetëm hyrja në Kosovë me dt.23.09.2020 në ora 15:22:25, si dhe me video-incizimet e bëra, nga vetë ky dëshmitar, Gjykata këtë pjesë të deklaratimit nuk e ka vlerësuar pasi që ka të bëjë me të akuzuarin A.K për të cilin është veçuar procedura penale.

Sa i përket pjesës tjetër të dëshmisë së këtij dëshmitari, gjykata vlerëson se e njëjta nuk mbështetet dhe me provat tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, si në rastin kur pohon se transportimi i tij për në Republikën e Shqipërisë është bërë me urdhër të akuzuarit L.K, se parat i janë dhënë A.it për punë që është dashur ta krye përmes një shefi, që kinse atëherë nuk e ka njohur por tani po e njehë, se për urdhër ka kuptuar pas videoincizimit që ka parë më vonë, pastaj, se A.it i kanë dhënë shumë prej 65.000.00 euro, ani pse vetë ka pohuar se ja ka dhënë njëherë 5.000 euro, pastaj 5.500 euro, edhe njëherë 2-3 mije, e që sipas tij fjalën e ka edhe për shumat që ja ka dhënë babai i tij, përfshirë edhe veturën.

Gjykata në rishqyrtimin gjyqësor të datës 09.01.2024 me propozimin dhe pëlqimin e palëve ka lexuar dëshminë e dëshmitarit B.P, të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të kaluar, ku kishte deklaruar se qëndron pran deklaratës së dhënë në prokurori me dt.28.01.2021, duke shtuar se B.M e njehë pasi që vin nga i njëjti vend, ndërsa që A.K, e ka takuar dy apo tri herë, në kafiterin “trend Caffè”, Prishtinë. Si janë njohur dhe çfarë raporte ka pasur B.i me A.in, nuk e din, mirëpo që një rast, me kërkesën e B.it i ka huazuar A.it shumën prej 2.000 euro, sa i kujtohet huazimi i parave ka ndodhur 2 apo 3 jave dite para se B.i me shku në burg, dhe se këto nuk i janë ka kthyer asnjëherë, ndërsa që vetë A.i nuk i ka kërkuar asnjëherë para. Në deklaratën e dhënë në Prokurori me dt.28.01.2021, ngjashëm ka deklaruar si në dëshminë e dhënë në shqyrtim gjyqësor, duke shtuar se B.i i kishte përmendur se është duke e ndihmuar A.i për diçka për probleme e tij me ligjin dhe se ja ka dhënë dikujt një veturë, mirëpo për më shumë nuk din.

Gjykata këtë pjesë të deklarimit nuk e ka vlerësuar pasi që ka të bëjë me të akuzuarin A.K për të cilin është veçuar procedura penale.

Gjykata në rishqyrtimin gjyqësor të datës 09.01.2024 me propozimin dhe pëlqimin e palëve ka lexuar dëshminë e dëshmitarit B.B, të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të kaluar, ku kishte deklaruar se mbetë pran deklaratave të dhëna ne polici me date 13.04.2021, si dhe me datën 25.03.2021, duke shtuar se është drejtor menaxhues ne kompaninë “S... Studio”, me seli në Prishtine, bashkëpunim me ... si kompani, nuk kanë pasur, mirëpo sipas kërkesës së kompanisë G..., e kanë furnizuar me mobileje KPK-së, ndërsa që nuk i kujtohen rrethana tjera se si është kryer furnizimi, lloji apo sasia e produkteve, por që këto të dhëna mund të gjenden në fatura të mallit. Më tutje është ballafaquar me pjesë të caktuara të deklaratës së dhënë në Polici me date 13.04.2021, ku kishte deklaruar se “Nuk e di sakte datën mirëpo sipas kërkesë se kompanisë “G...” duhet te jete disa dite para faturës se lartcekur me numër 89-21-001-21 te datës 10.02.2021”, është përgjigjur se kjo është e saktë, pastaj në pyetjen se “Sipas informatave që ka polica dhe prokuroria dërgesa e dërguar ne KPK është bere ne me date 02.02.2021 a mund te jete kjo date e liferimit te këtyre mobileve nga firma juaj ne KPK-“ ishte përgjigjur “Po, mund te jete si date, mirëpo nuk e di sakte”, ka deklaruar se kështu është përgjigjur. Po ashtu, ka pohuar se është e saktë pjesa e deklaratës së dhënë në polici me dt.25.03.2022, kur në pyetjen se a e njihni ju F.D, ishte përgjigjur “Po e njoh sepse atu i kemi dorëzuar fatura para 2 viteve kur kemi bere furnizimin e pare me mobilie për KPK-në”, dhe po ashtu ka konfirmuar përgjigjen në pyetjen tjetër të shtruar po në të njëjtën deklaratë, se “A janë dorëzuar këto mobilie sipas faturës ne KPK, kush ka qene pranues dorëzues i këtyre faturave, dhe nënshkrimi i kujt është ne fature?”, ishte përgjigjur “Po, janë dorëzuar nga punëtorët e S... Studio te cilët kane pasur obligim që kur te shkoj me i dorëzu te lajmërohen tek L.i, ndërsa kush i ka pranuar nga zyrtaret e KPK-se, unë nuk kam njohuri ndërsa fatura është pranuar nga B.L sepse ne kemi bërë marrëveshjen me B. e jo me KPK-ne” duke deklaruar se vetëm pjesa e përgjigjes me u lajmëru tek L.i, nuk i kujtohet nëse e ka pohuar. Edhe në deklaratë e dhëna në procedurën paraprake, ne polici me date 13.04.2021, si dhe me datën 25.03.2021, ngjashëm ka deklaruar se porosinë e mallit sipas faturës 89-21-001-21 të dt.10.02.2021 e ka bërë “G...”, mall i cili është dërguar në KPK disa ditë para datës në faturë dhe se kush i ka pranuar të njëjtat në KPK nuk e din, siç nuk ka njohur nëse ndonjë persona nga KPK ka qenë në mobilierinë “S...” dhe nëse po kush ka qenë. Gjykata ka vlerësuar dhe dëshminë e këtij dëshmitari, të cilën dëshmi e ka gjetur si dëshmi objektive, të sinqertë dhe reale, e cila si e tillë është në përputhje edhe me dëshmitë e dëshmitarëve tjerë dhe provave materiale

të administruar në këtë çështje penale, e nga e cila ka vërtetuar faktin se mobilet në KPK nga kompani "S...", janë dërguar sipas kërkesës së kompanisë "G...", pra se kjo kompani nuk ka pasur kontratë të lidhur me KPK-në, dhe as obligime ndaj të njëjtës, ndërsa që dëshmitari, duke qenë i sigurtë ne pohimet e tij, ka deklaruar se nuk është i sigurt për kohën se kur janë dërguar, duke ju referuar faturës me nr.89-21-001-21 të dt.10.02.2021, përkatësisht faktit se mobilet janë dërguar disa ditë para datës së kësaj fature, e poashtu duke qenë jo i sigurt nëse, punëtorët e kompanisë të cilët i kanë dërguar mobilet kanë pasur me u lajmëruar te i akuzuari L.K.

Gjykata duke e vlerësuar shkallen e lartë të sinjeritetit të këtij dëshmitari dhe objektive lidhur me rrethanat për të cilat ky dëshmitar, i ka pohuar me si G. të plotë në dëshminë në shqyrtim gjyqësor, ndërsa që vlerëson se besueshmëria në ekzistimin e rrethanave për të cilat vetë dëshmitari nuk është i sigurt në qenien e tyre, është jo e plotë, dhe vërtetimi i këtyre rrethanave nuk mund të mbështetet në dëshminë e këtij dëshmitari.

Gjykata në rishqyrtimin gjyqësor të datës 09.01.2024 me propozimin dhe pëlqimin e palëve ka lexuar dëshminë e dëshmitarit S.B, të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të kaluar, ku kishte deklaruar se qëndron pran deklaratave të dhëna në Polici me date 23.04.2021, dhe 23.03.2021, për të shtuar se është noter në Prishtinë, ku ofron shërbime noteriale, gjithmonë duke zbatuar praktikën dhe standarde me të mira profesionale. Lidhur me kontratën për shitblerjen e veturës T-Roc me numër LRP 16008/2019 REF.3464/2019, ka deklaruar se si e tillë nuk i kujtohet, mirëpo te gjitha aktet te cilat janë vërtetuar ne zyre e tij janë dorëzuar me rastin e dhënies së deklaratës në polici, dhe gjithashtu origjinalet janë ne arkivat e noterit, nuk i mban mend palët në këtë kontratë dhe as kush ka qenë prezent gjatë lidhjes së të njëjtës, dhe as sa ka qenë çmimi transaksionit, meqenëse është çmimi që caktohet nga vetë palët, gjithmonë duke i këshilluar që vlera duhet te jete e vërtetë, mund te inkriminohen nëse deklarojnë vlera te pavërteta. Sipas kontratës rezulton se Shitësi është entitet-H. SHPK, te cilin e përfaqëson B.M me autorizim, gjithashtu ky autorizim është bërë në zyrën e tij noteriale, ndërsa blerësi është M.B. Sa i përket personave konkret që kanë qenë prezent ka theksuar se nëse ka qene palë kontraktuese nuk ka mundësi që te mos jete prezent, L.K nuk ka qenë sepse duke qenë se e ka njohur dhe ka pasur bashkëpunim me parë, do i ishte kujtuar prezenca e tij, M.B nuk e njehë personalisht përpos qe e di qe është pale ne rast, siç nuk e njehë dhe as që i kujtohet B.M. Ka shtuar se gjithmonë i këshilloj palët që pagesa duhet të bëhet përmes bankës pasi që siguria juridike është ne shërbim te transaksionit, edhe pse për vlerat nen 10 mije euro për bartjen e lendeve kontraktuese nuk kërkohet pagesa përmes transaksionit bankar, nuk praktikohet pagesat kesh në zyre dhe në asnjë rast nuk ka mundur të ndodh një situatë e tillë dhe asnjëherë nuk ka parë ndonjë deklaratë te shkruar lidhur me një shume prej 8.400 mije euro. Edhe në deklaratat e dhëna në Polici me date 23.04.2021, dhe 23.03.2021, ka përshkruar detyrat e tij si noter, duke shpjeguar procedurat që duhet ndiqen në rastin e lidhjes se kontratave të natyrave të ndryshme, standardëve dhe praktikave që zbatojnë, duke shtuar se konkretisht nuk i kujtohet rasti i kontratës së shitblerjes së veturës T-Roc me numër LRP 16008/2019 REF.3464/2019, mirëpo pas shikim të së njëjtës, ka konstatuar se në këtë kontratë si shitës figuron me autorizim B.M, ndërsa që blerëse M.B, duke shpjeguar me tutje rrethana tjera në mënyrë të njëjtë si në shqyrtim gjyqësor.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e këtij dëshmitari, të cilët dëshmi po ashtu e vlerëson si dëshmi objektive, reale dhe të sigurtë, që është në përputhje edhe me dëshmitë e dëshmitarëve

tjerë, provave materiale, si dhe vetë deklarativë që ky dëshmitar ka dhënë në procedurën paraprake, me ç'rast ka përshkruar autorizimet e ti ligjore, praktikat dhe standarde që ndiqen dhe zbatohen në rastin e lidhjes së kontratave, të çfarëdo lloj natyre, e që më dëshminë e këtij dëshmitari janë vërtetuar rrethanat që kontrata është lidhur pikërisht në zyrën noteriale ku këtij dëshmitar ka cilësinë e noterit, se kontrata ka të bëjë me shitblerjen e veturës, dhe është lidhur në mes M.B si blerëse dhe B.M që figuron si shitës me autorizim, për shumën e cila është përshkruar si në kontratë. Po ashtu nga dëshmia e këtij dëshmitari vërtetohet se në asnjë rast, përfshirë edhe në rastin në fjalë nuk është praktikuar dhe nuk praktikohet pagesa kesh në zyre, dhe se nuk ka parë asnjë lloj deklarate të shkruar në të cilën është konstatuar se janë dhënë shuma të caktuar në kesh, për çfarëdo lloj arsye.

Gjykata në rishqyrtimin gjyqësor të datës 09.01.2024 me propozimin dhe pëlqimin e palëve ka lexuar dëshminë e dëshmitares E.SH, të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të kaluar, ku kishte deklaruar se punon në ..., ndërsa që nga viti 2018 punon zyrtare e prokurimit, angazhimi kryesor i të cilës zyre është procesi që nga shpallja e tenderëve, deri tek nënshkrimi i kontratës. Pastaj ka bërë përshkrimin e procedurës së prokurimit, duke filluar nga plani i prokurimit, kërkesa për iniciimin e tenderit, zyra e prokurimit e shpall tenderin, hapjen, vlerësimin, e përzgjedhja e fituesit, njoftimi për dhënien e kontratës pasi që shpallet fituesi, njoftimi për nënshkrimin e kontratës, dhe nënshkrimi i kontratës. Sa i përket projektit të furnizimit me mobilie ekskluzive për kabinetin e kryesuesit të KPK-se me numër psh. 250-021-001-136, ka theksuar se njësia kërkuese që ka qene departamenti i zyrës së përgjithshëm, edhe pse nuk është e sigurt, në kohën e vlerësimit të tenderëve ka qenë në pushim mjekësor, ndërsa që është caktuar në komisionin e pranimit ku kanë bere edhe pranimitin e mobilieve, mirëpo sa ka njohur menaxherja e prokurimit F.D e ka kërkuar nga AQP-ja, aprovimin për shpalljen e procedurës, përgjigja nga AQP-ja ka qene pozitive, konkretisht kane lejuar iniciimin e procedurave për tenderim. Ka shtuar se zyrtar e prokurimit publik pranë KPK-se, ka pasur kontrate për inventar për zyre me kompaninë Mobelant, por në kontrate nuk ka pasur mobilie ekskluzive. Me dt.19.02 2021, është caktuar komision me anëtar dëshmitari, L.D dhe M.B dhe unë, me datën 26.02.2021, ka qenë në zyrën e kryesuesit të KPK-se, ku kane ardhur tre dollapa, dhe pas montimit është bërë një dollap, pastaj është ndryshuar vendimi, është larguar nga vendimi M.B dhe në vend të saj është V.C, dhe me datën 05.03.2021 si komision kanë shkuar në zyrën e kryesuesit dhe e kanë verifikuar dhe konfirmu te gjithë inventarit sipas specifikave te kontratës dhe ne fund kanë bërë një raport ku kanë konstatuar se gjitha furnizimet kane qene si ne baze te specifikave te kontratës. Dëshmitari është ballafaquar me deklaratën e dhënë në prokurori me datë 01.04.2021, ku në pyetjen kur kane ardhur këto mobilie ne zyrën e kryesuesit të KPK-se, kishte deklaruar “Unë si anëtare e komisionit siç e cekta me larte orament-dollapet te cekura ne raportet e pranimit te mallit e te datës 05.03.2021 i kam pranuar me datës 26.02.2021, ndërsa furnizimi te cekura nga numër 1 deri ne 8 unë nuk kam qene prezent kur është bere furnizimi përveç asaj dite te datës 05.03..2021 ku ne kemi shkuar si komision i pranimit dhe kemi verifikuar se te gjitha artikujt, mobiliet kane qene te vendosura ne zyrën e kryesuesit të KPK-se”, ka pohuar se kështu ka deklaruar, duke shtuar se mobiliet nga 1 deri ne 8, kanë qenë, karrige statike për takime, tavoline për takime, fotele statike, tavoline anësore, karrige statike për takime, tavoline e kafes ne forme rrethore, tavoline anësore ne forme rrethore, karrige ekzekutivit, dhe nuk e din kur janë vendosur në KPK. Në deklaratat e dhëna në procedurë paraprake, përkatësisht deklaratën e dhënë në Polici me dt.

01.04.2021, ngjashëm ka deklaruar se ka qenë anëtare e komisionit për pranimin e projektit “Furnizim me mobileje ekskluzive për kabinetin e ... të Republikës së Kosovës me nr.identifikues PSH250-021-001-136”,ku ka përshtuar detyrat e komisionit, faktin se për mobiliet e specifikuar nga 1 deri 8 nuk e din kur kanë ardhur në KPK dhe kush i ka sjell të njëjta, përveç që me dt.05.03.2021, kur është bërë verifikimi dhe pranimi kanë qenë të vendosura në zyrën e kryesuesit të KPK-së, ndërsa që për ormanët-dollapet të cekura në raportin e pranimit me dt.05.03.2021 janë pranuar me dt.26.02.2021 dhe janë sjell nga kompania “G...”.

Gjykata në rishqyrtimin gjyqësor të datës 09.01.2024 me propozimin dhe pëlqimin e palëve ka lexuar dëshminë e dëshmitares L.D, të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të kaluar, ku kishte deklaruar se qëndroni pranë deklaratës se dhënë në polici me date 01.04.2021, duke shtuar se prej datës 05.02.2021 punon ne sekretariatit e KPK-se, si zyrtare ligjore në ..., që merret me hartimin e akteve normative, akteve te tjera ligjore, opinion ligjore, rekomandime profesionale. Ka pohuar se ka qenë e caktuar me vendim e datës 19.02.2021 te drejtorit te sekretariatit L.K si kryetare e komisionit për pranimin e projektit furnizim me mobilie, dhe detyra e tyre ka qenë pranimin dhe konfirmimin e furnizimit me mobilie sipas specifikave te kontratës dhe me atë rast me date 25 ose 26 shkurt kanë pranuar 3 dollap me xhama qe janë bashkuar janë bërë një. Pastaj kanë pranuar pjesën tjetër të mobileve, që data nuk i kujtohet por që sa i kujtohet kanë pranuar ormani, tavolina edhe karriget, dhe sa i kujtohet në bluzat e punëtoreve që i kanë bartë mobiliet ka shkuar “G...”. Po ashtu ka pohuar se është caktuar anëtare e komisionit me vendimin e dt.05.03.2021, që ka pasur për detyre me i pranu dhe me i konfirmu mobiliet sipas specifikes se kontratës. Dëshmitarja është ballafaquar me pjesën e deklaratës se dhënë në Polici me date 01.04.2021, ku në pyetjen se “a keni njohuri datën dhe kompaninë furnizues se kur kane ardhur mobiliet e cekura ne raportin e pranimit te mallrave komisioni i datës 05.03.2021 nga numri 1 deri ne numrin 8”, ishte përgjigjur “Jo nuk e di as datën e as cila kompani i ka sjell si dhe nga kush janë pranuar, përveç ormanëve te sjelle nga kompania G...qe kam qene ne fund te shkurtit 2021” ka pohuar se kështu ka deklaruar, duke shtuar se detyra e tyre ka qenë vetëm të konstatohet se a janë përmbush specifikat dhe a është sasia e përcaktuar si kontratë. Në deklaratën e dhënë në Polici me date 01.04.2021, ngjashëm ka deklaruar, lidhur me rrethanat për të cilat është pyetur, ndërsa që për dallimet eventuale në deklarim lidhur me rrethanat e caktuara është ballafaquar gjatë dëshmisë së dhënë në shqyrtim gjyqësor.

Gjykata në rishqyrtimin gjyqësor të datës 09.01.2024 me propozimin dhe pëlqimin e palëve ka lexuar dëshminë e dëshmitarit V.C, të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të kaluar, ku kishte deklaruar se qëndron pas deklaratës së dhënë në polici me dt.01.04.2021, në kohën e dhënies së deklaratës ka punuar zyrtarit ligjor ndërsa tash e ushtron pozitën e udhëheqësit te zyrës ligjore në .... Ka shtuar se ka qenë i caktuar si anëtar i komisionit për pranimin e mobileve për kryesuesin e KPK-se në vitin 2019, si zëvendësim i anëtares M.B, me vendimin e dt.05.03.2021, të nxjerr nga ushtruesi i drejtorit të përgjithshëm i sekretariatit V.K, ku anëtare kanë qenë edhe L.D dhe E.SH. Ka shtuar se detyra e komisionit ka qenë verifikimi dhe pranimi e mobileve ekskluzive sipas kontratës për kabinetin e kryesuesit, ashtu që kanë marre kontratën me specifikat dhe kanë verifikuar të gjithë artikujt sipas specifikave dhe asnjë artikuj nuk ka munguar, dhe për këtë kanë përpiluar raport me date 5.3.2021 dhe puna e komisionit ka përfunduar atë ne momentin e dorëzimit te raportit. Nuk i kujtohet se çfarë lloj i mobileve kanë qenë, operator ekonomik ka qenë “G...”, nuk i kujtohet a është pranuar ndonjë mall-mobilie nga kompania

“S...”, çmimet e mobileve ne fjale për njësi nuk e din dhe nuk ka qenë obligim i tyre si komision me i verifikuar faturat për mobiliet e pranuar. Dëshmitari po ashtu edhe në deklaratën e dhënë në polici me dt.01.04.2021, ka përshkruar në mënyrë të njëjtës veprimet e tij si anëtar i komisionit për pranimin e mobileve sipas kontratës me numër PSH 250-01-001-136 furnizim me mobilie” për kryesuesin e KPK-se, duke shpjeguar veprimet që kanë ndërmarr si komision në funksion të pranimit dhe verifikimit të mobileve, duke shtuar se në momentin kur me dt.05.03.2021 kanë konfirmuar se mobiliet sipas kontratës gjendjen zyrën e kryesuesit dhe janë me specifikat si në kontratë, kanë përpiluar raport, dhe me aq ka përfunduar puna e tyre si komision.

Gjykata në rishqyrtimin gjyqësor të datës 09.01.2024 me propozimin dhe pëlqimin e palëve ka lexuar dëshminë e dëshmitarit I.H, të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të kaluar, ku kishte deklaruar se qëndron pran deklaratës së dhënë në Polici me dt.07.04.2021, duke shtuar se punon në ..., për tri vite ka punuar si zyrtar i administratës, ndërsa që 2 muaj punon si zyrtar i logjistikes në kuadër të KPK-se. Ka qenë i caktuar si menaxher i kontratës me numër PSH 250-01-001-136 furnizim me mobilie” për kryesuesin e KPK-se, dhe në këtë drejtim duke pas për detyrë zbatimin e kontratës për furnizim, me date 26 shkurt të vitit 2021 është njoftuar nga zyra e prokurimit që me dal me pranë një orman që është sjell na kompania, dhe kështu ka vepruar, ormani është dërguar në zyrën e kryesuesit, sipas kërkesës së zyrës së prokurimit, dhe në zyre ka vërejtur që kanë qenë tjera mobileje siç janë tavolina dhe fotele për të cilat nuk e ka ditur si janë vendosur aty dhe kush i ka sjell. Kompania që i ka sjell ormanin ka qenë kompania “G...”, dhe prezent kanë qenë edhe anëtarët e komisionit E.SH, M.B dhe L.D, si menaxher ka pranuar faturat të cilat edhe i ka nënshkruar pas pranimit të mobileve, siç është konstatuar nga komisioni. Në deklaratën të dhënë në Polici me dt.07.04.2021, ngjashëm ka deklaruar se sipas vendimit të dt.16.02.2021 ka qenë i caktuar si menaxher i kontratës me numër PSH 250-01-001-136 furnizim me mobilie” për kryesuesin e KPK-se, ka njohur vetëm për mobiliet e sjell nga “G...” të cilat janë pranuar në KPK me dt.26.02.2021, ndërsa që për mobiliet e përshkruara nga nr.1-8, nuk ka njohur se kush i ka sjell dhe në çfarë date, mirëpo që me datë 26.02.2021 kanë qenë të vendosura në zyrën e kryesuesit të KPK-së.

Gjykata ka vlerësuar dëshmitë e dëshmitarëve E.SH, L.D, V.C dhe I.H të cilat dëshmi i ka gjetur dhe vlerësuar si reale dhe sinqerta, e nga të cilat dëshmi është vërtetuar se këta dëshmitar kanë qenë anëtar të komisionit për pranimin e mallit lidhur kontratën-projektin “Furnizim me mobileje ekskluzive për kabinetin e ... të Republikës së Kosovës me nr.identifikues PSH250-021-001-136” dhe në këtë cilësi kanë bërë verifikimin e zbatueshmeris së kontratës, dhe se lidhur me këtë kanë përpiluar raport, ku kanë konstatuar se kontrata është përmbushur në tërësi nga operatori ekonomikë, në sasi dhe specifikat e kërkuara si në kontratë, e duke cekur njëherit se mobiliet nga 1 deri në 8, ku kanë qenë të përfshira, karrige statike për takime, tavoline për takime, fototele statike, tavoline anësore, karrige statike për takime, tavoline e kafes në forme rrethore, tavoline anësore ne forme rrethore, karrige ekzekutivit, nuk kanë njohuri se kur janë vendosur në KPK, mirëpo që të njëjta kanë qenë në sasi dhe specifika sipas kontratës, siç është konstatuar në raportin e dt.05.03.2021. Këta dëshmitar duke qenë anëtar të komisionit për pranimin e mobileve për kryesuesin e KPK-se në vitin 2019, përkatësisht dëshmitari I.H menaxher i kontratës, kanë përshkruar në mënyrë të ngjashme të gjitha rrethanat për të cilat kanë qenë në dijeni si anëtar të komisionit, duke rritur besueshmërinë në objektivitetin e këtyre dëshmimeve, për ekzistimin e rrethanave të cilat vërtetohen përmes të njëjtave.

Gjykata në rishqyrtimin gjyqësor të datës 09.01.2024 me propozimin dhe pëlqimin e palëve ka lexuar dëshminë e dëshmitarit F.K, të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të kaluar, ku kishte deklaruar se dëshmitarin bashkëpunues B.M e njehë si qytetar, nuk na lidhe diçka familjare dhe as biznese me te, mirëpo kur janë takuar në rrugë janë përshëndetur pasi që i njëjti ka pasur një lokal lagjen Ulpiane në Prishtinë, ndërsa që A.K e njeh përmes B.it, pasi që dëshmitari ka pasur një shtëpi për me leshu me qira dhe lidhur me këtë e ka kontaktuar B.i, janë takuar me B.in dhe A.in, kanë shikuar shtëpinë edhe janë pajtuar qe shtëpia te mirret me qira dhe personi i cili ka pasur me qëndruar ne shtëpi ka qene A.i me familjen e vet, shtëpia gjindet ne Cagllavice në lagjen Nice, çmimi i qerese reale atu ka qene 600 deri 700 euro, dhe B.i i ka thënë se është për një shok të tij dhe kur e ka kuptuar që është në pyetje A.i edhe se me familje ka me qëndruar në atë shtëpi, është pajtuar që qiraja të jetë 400 euro mujore dhe qiranë ka vazhduar me pagu B.M, ndërsa kontratë nuk është bërë dhe pagesat e qeras janë bërë me para kesh. B.i nuk i ka tregu për çfarë arsye po ja paguan obligimet e qerese A.it, A.i ka qëndruar rreth 1 vit dhe pastaj është larguar pa e njoftuar paraprakisht, mirëpo vetëm duke i treguar se ku e ka lën çelësin e shtëpisë, dhe ndërkohe dëshmitari ka kuptuar se A.i dhe B.i kanë një lloj mosmarrëveshje ndërmjet tyre. Në deklaratën e dhënë në Prokurori me dt.02.02.2021, ka deklaruar se me B.M njihen nga punët bujqësore, në vitin 2019 e ka publikuar një njoftim për lëshimin e shtëpisë me qira në lagjen “Nic” Cagllavic, për këtë është kontaktuar nga B.i, pastaj i njëjtit s’bashku me A. kanë shkuar tek shtëpia të cilën e ofronte për qira, dhe kanë ra dakord për çmimin e qira prej 400 euro, shtëpia ka qenë për Ardinain dhe qiranë e ka paguar B.i.

Gjykata dëshminë e këtij dëshmitari, nuk e ka vlerësuar pasi që ka të bëjë me të akuzuarin A.K për të cilin është veçuar procedura penale.

Gjykata në rishqyrtimin gjyqësor të datës 09.01.2024 me propozimin dhe pëlqimin e palëve ka lexuar dëshminë e dëshmitarit B.D, të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të kaluar, ku kishte deklaruar se që nga vitit 2012 punon në ..., si auditor i brendshëm. Sa i përket blerjes së mobileve në vlerë prej 9.480 euro, nga Operatori ekonomik, “G...”, ka theksuar se për këtë është informuar nga UD i drejtorit i Sekretariatit V.K, i cili i ka kërkuar që të shiqojë apo të rivlerësojë tërë procesin e kësaj lënde, me ç’rast ka vërejtur se kishte shkelje ligjore, sa i përket faktit se inicimi i procedurës së prokurimit nuk ishte bërë nga Divizioni i shërbimeve të përgjithshme por nga asistentja e Kryesuesit të KPK-së, me emrin N., specifikat teknike për pajisjet për zyrën e kryesuesit të KPK-së, nuk ishin bërë nga Divizioni i shërbimeve të përgjithshme, dhe pajisjet për zyrë të kryesuesit të KPK-së ishin ardhur para nënshkrimit të kontratës që nënkupton se operatori ekonomik, në këtë rast ishte i paracaktuar, kjo bën shkelje ligjore të parimeve bazë të ligjit të prokurimit publik nenit 7 të këtij ligji i cili ka të bëjë me trajtimin e barabartë të palëve, apo mos diskriminimi. Lidhur me këto të gjetura ka biseduar me anëtarët e komisionit për pranimin e mallit në përbërje prej tre anëtarëve siç është L.D, V.C, E.SH, si dhe pranuesin teknik Y.SH, dhe menaxheri i kontratës I.H, të cilët i kanë pohuar se të gjitha mallrat janë pranuar konform kontratës, dhe e kanë nënshkruar dokumentin apo formularin mbi pranimin e mallit. Ka shtuar se KPK ka pasur një kontratë valide me “M...” SHPK dhe është praktikë e gabuar nëpër organizatat buxhetore që të lidhin kontrata për artikuj të njëjte me operatorë të tjerë. Aq më tepër “M...” sipas specifikave të përpiluara nga KPK kishte edhe pajisje ekskluzive. Andaj, nuk e din cila ka qenë arsyeja e lidhjes së një kontrate tjetër me G.... Ka theksuar se dhe pse nuk ka qenë



në punë, nga shtëpia ka hap llap topin për punë dhe me rastin e hapjes shfaqet Web faqja e KPK-së, ka vërejtur në mënyrë vizuale fotot që figurojnë nga 4 shkurti 2021 se tash më pajisjet ishin në zyrën e kryesuesit, ndërsa që gjatë auditimit ka vërejtur se në flete dërgese mungonin datat e liferimit të mallit dhe se kjo është shkelja që është bërë, pranimi i mallit para nënshkrimit të kontratës. Ka shtuar se përgjegjësi kryesor për procesin e tenderimit në KPK është Divizioni i prokurimit, procesi i tenderimit autorizohet nga zyrtari kryesor administrativ (ZKA) në rastin konkret drejtori i përgjithshëm i Sekretariatit, njësitë kërkuese bëjnë kërkesa për planifikim për nevojat e tyre, në këtë rast ka qenë njësi kërkuese asistentja e kryesuesit, autorizimi i procedurave të prokurimit nënkupton se janë përmbushur të gjitha nevojat për shpalljen publike të tenderëve, fillimisht formohet Komisioni për hapjen e ofertave që e themelon përgjegjësia e prokurimit, e më pastaj është komisioni për vlerësimin e ofertave, që e themelon ZKA – drejtori i përgjithshëm, anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave financiare janë të pavarur në vlerësimin e ofertave në bazë të kushteve të tenderit të shpallur të tenderit, bën vlerësimin e ofertave në të gjitha proceset dhe më në fund bën përzgjedhjen e operatorit ekonomik, dhe nënshkruajnë raportin, përgjegjës për pranimin e mallit pas nënshkrimit të kontratave është Komisioni ose anëtarët e Komisionit sipas vendimit që nxjerrë ZKA-Zyra e drejtorit dhe kontrata nënshkruhet nga përgjegjësja e prokurimit. Në rastin konkret, ka theksuar se kanë pas mundësi të gjithë operatorët ekonomik të ofrojnë ofertat e tyre, me rastin e zgjedhjes të një ofertuesi janë njoftuar edhe operatorët tjerë se janë refuzuar ofertat e tyre, të njëjtit kanë mundur të bëjë ankesë në OSHP dhe nuk ka pas ankesë lidhur me këtë tender, mirëpo sipas dëshmitarit këto procedura janë fiktive dhe janë lidhur me nenin 7 të Ligjit për prokurimin publik pasi që të gjitha mallrat janë ardhur nga operatori i paracaktuar, të gjitha procedurat e tenderimit janë zhvilluar në rregull, por vërejtët e auditorit të brendshëm janë se pajisjet janë ardhur para se me u nënshkruar kontratat. Edhe në deklaratën e dhënë në procedurën paraprake, përkatësisht deklaratën në Prokurori me dt.09.03.2021, ngjashëm ka deklaruar për rrethanat për të cilat është pyetur.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e këtij dëshmitari, dëshmi të cilën e ka gjetur si pjesërisht të objektive, meqenëse në disa drejtime është jo vetëm në kundërshtim me dëshmitë e provat tjera materiale por edhe me vetë vete kundërthënëse, siç është rasti, kur pohon se KPK ka pasur një kontratë valide me “M... “SHPK dhe është praktikë e gabuar nëpër organizatat buxhetore që të lidhin kontrata për artikuj të njëjte me operatorë të tjerë, gjë që nuk është kontestuese se ka pasur një kontratë valide, mirëpo siç është vërtetuar dhe me provat tjera materiale dhe dëshmitë e dëshmitarëve, në kuadër të asaj kontrate nuk kanë qenë të përfshirë artikujt me specifikat e kërkuara. Pastaj ky dëshmitar derisa në një rënë anë ka deklaruar se procedura ka qenë fiktive, është shkelur neni 7 i Ligjit për prokurimin publik, në anën tjetër deklaroi se të gjitha procedurat e tenderimit janë zhvilluar në rregull, por vërejtët e auditorit të brendshëm janë se pajisjet janë ardhur para se me u nënshkruar kontratat, duke mos arritur të shpjegoj se si ka konstatuar se procedura ka qenë fiktive dhe është shkelur neni 7 LPP përderisa procedura ka qenë në rregull, për më tepër që pjesë e procedurës kanë qenë 3 operator, të cilët kanë paraqitur ofertat e tyre, janë njoftuar me kohë për të gjithë fazat e procedurës, përfshirë shpalljen e fituesit, mirëpo të cilët nuk kanë paraqitur ankesë.

Gjykata në rishqyrtimin gjyqësor të datës 09.01.2024 me propozimin dhe pëlqimin e palëve ka lexuar dëshminë e dëshmitarit I.S, të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të kaluar, ku kishte deklaruar se qëndron pas deklaratës së dhënë në prokurori me dt.28.01.2021, është i angazhuar

në ndërtim, B.Mn e ka dajë, veturën e tij e tipit ËV Trock që ka qenë në emër te kompanisë së tij “të H.” në vitin 2019, ja ka dhënë B.i në shfrytëzim për 10 dite apo 2 jave, meqenëse i ka thënë se nuk ka makinë, duke qenë se pas 2 muaj, B.i ka bere ndeshje me atë veturë, janë pajtuar që B.i me mbajt veturën, ndërsa me ja dhënë edhe 5 mijë euro B.it dhe i njëjti me i paguar një veturë të njëjtë, gjë që deri tani nuk e ka bërë, ndërsa që çelësin rezerve te veturës, e ka mbajtur dëshmitari, të cilin edhe e ka dorëzuar në prokurori. Ka shtuar se ka qenë duke rrugëtuar me familje kur e ka thirre B.i dhe i ka kërkuar që të shkoj te noteri me ja dhënë një autorizim apo kontrate, përcka edhe ka vepruar ashtu, ka nënshkruar dhe është larguar menjëherë, nuk është i sigurt çka ka nënshkruar dhe as nuk e dinë arsyen pse i është dashur B.it një autorizim apo kontratë e tillë, nuk i kujtohet se kush ka qenë prezent, dhe përsëri pasi është kthyer nga salla në gjykatore nuk ka arritur të identifikoj ndonjë person që ka qenë prezent atë ditë te noteri. Ka deklaruar se e njehë A.K nga fakti se ka ndejt në loklain “Solo” në Dardani, dy apo tri here me të, aty ka qenë edhe B.i, mirëpo që A.in e njeh përmes shokëve tjerë dhe jo përmes B.it. Ka theksuar se B.i gjithë ka pasur probleme kapak, mirëpo nuk i kujtohet ndonjë rast specifik, përfshirë edhe ndonjë problem për veturën që e kishte marr nga dëshmitari, mirëpo i kujtohet që B.i me herët i kishte thënë që po e shes veturën sepse ja kam dhënë veturën një shoku tim, dhe ty ta blej atë te re siç jemi marr vesh, ndërsa që me vonë ka marr vesh se ka pasur probleme me A.in sa i përket makinës. Dëshmitari është ballafaquar me pjesën e deklaratës të dhënë në Prokurori me dt.28.01.2021, ku në pyetjen “A u ka treguar B.i paraprakisht se kush janë personat te cilët e kanë blere veturën” ishte përgjigjur “Jo te them te drejtën unë nuk jam i interesuar sepse B.i me veturën time ka shkaktuar një aksident ne Llap pastaj e ka rregulluar atë e pastaj e ka shitur, sepse unë nuk kam dashur qe ta marr atë veturë të aksidentuar dhe jemi marr vesh qe ta blejmë një veturë të ngjashme te re dhe pjesën tjetër te gjejmë një mesatare se bashku, tani për këtë veturë B.i i bie qe me ka mbetur borxh rreth 13 mijë euro”, është përgjigjur se nuk i kujtohet shuma, por e dinë që janë pajtuar me i dhënë edhe 5 mijë euro, ndërsa ai me ja ble një veturë të njëjtë. Po ashtu edhe në deklaratën e dhënë në prokurori me dt.28.01.2021, njëjtë ka deklaruar mbi të gjitha rrethana për të cilët është pyetur, sa i përket njohjes me B.in dhe A.in, veturës VW “Trock” dhe arsyes së pranisë së tij te noteri, ditën e shitblerjes së veturës.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e këtij dëshmitari, të cilën e ka gjetur si dëshmi të sinqertë dhe objektive, që është në përputhje edhe me dëshmitë e dëshmitarëve tjerë por edhe me provat materiale, e nga e cila dëshmi vërtetohet fakti se veturën e tipit “T-roc” të cilën e ka blerë e akuzuara M.B, nga tani dëshmitari bashkëpunues B.M ka qenë në emër të këtij dëshmitari pra I.S, i cili dhe i ka dhënë autorizim dëshmitarit bashkëpunues B.M për shitjen e saj, mirëpo që në asnjë rast, dëshmitari bashkëpunues B.M, nuk i ka thënë ndonjë arsye specifike lidhur me shitjen e veturës, përkatësisht se shitja është fiktive, se është duke e dhënë veturën për këtë ose atë arsye, siç pretendon dëshmitari bashkëpunues B.M, të këtë thënë këtij dëshmitari kur i ka kërkuar të shkoj në zyrën noteriale për dhënien e autorizimit. Po ashtu nga ky dëshmitari vërtetohet fakti se me rastin e dhënies së veturës dëshmitarit bashkëpunues B.M, të njëjtit i ka dhënë vetëm një qelës të veturës, dhe se çelësin e dytë e ka poseduar vetë, duke hedh poshtë kështu dhe vërtetuar si të pa vërtet pretendimin e dëshmitarit bashkëpunues B.M, se kinse çelësin e dytë nuk ka dhënë të akuzuarës M.B për arsye të caktuar, meqenëse nuk ka qenë fjala fare për shitje, dhe nuk ka besuar se pala tjetër do të veproj ashtu siç kinse janë pajtuar.

Gjykata në rishqyrtimin gjyqësor të datës 09.01.2024 me propozimin dhe pëlqimin e palëve ka lexuar dëshminë e dëshmitares Z.K.D, të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të kaluar, ku kishte deklaruar se qëndron pas deklaratës së dhënë në Polici me dt.19.03.2021, duke shtuar se është specialiste e Mikrobiologjisë dhe punon në Institutin Kombëtar të shëndetit Publik të Kosovës-IKSHPK. Në departamentin e mikrobiologjisë çdo pacient i cili vjen për të bërë një analizë duhet të regjistrohen në sistemi i cili e ka emrin MEDLIS, pacientet nëse kanë nevojë për testimin për SARC-COV 2, regjistrohen me të dhënat e pacientit për të cilat janë të obligueshme të jepen, për çdo mostër të marrë të pacienti i jepet një bar kod ku nga sistemi jepet ky barkod, dhe mostra e marrë dërgohet në laboratorin ku duhet të testohet dhe pas testimit i njëjti rezultat kthehet tek regjistrimi, ku regjistrohet nga mjeku i cili e ka testuar nëse është pozitiv apo negativ, dhe verifikohet prej mjekut pasi ta kontrolloj rezultatin se a e ka shkruar mire, zyra e pranimit ku është bërë edhe regjistrimi në fillim e shtyp rezultatin dhe i jep pacientit, ndërsa rezultati del me faksimil të mjekut pasi forma është elektronike nga vet sistemi, dhe çdo mjek për tu qasur në sistemin MEDDLIs e ka një usernamen dhe pasëordin e vet dhe në bazë të kësaj del dhe faksimili në mënyrë elektronike. Pas i është ofruar në shqimi raporti mikrobiologjik me numër ID 753, 131, të datës 19.08.2020, testi SARS-COV 2, ka deklaruar se në shikim të parë është vërejtur se është falsifikim, faksimili dhe nënshkrimi dëshmitares pasi forma si është vendosur nuk është në sistemin e tyre, ndërsa sa i përket numrit të bar kodit i njëjti mund të jetë edhe nga instituti pasi që është formë e njëjte. Dëshmitarja edhe në deklaratën e dhënë në Polici me dt.19.03.2021, ngjashëm ka përshkruar të gjitha rrethanat që lidhen me vendin e saj të punës, pastaj mënyrën e ekzaminimit mikrobiologjik, përfshirë testimet e natyrave të ndryshme, në këtë kuadër edhe testet për “Covid”, duke shtuar se rezultati i ekzaminimit mikrobiologjik me numër ID 753, 131, të datës 19.08.2020, testi SARS-COV 2, është i falsifikuar, nënshkrimi nuk është i saj dhe faksimilja është e falsifikuar dhe mund të jenë të marra nga ndonjë rezultat i lëshuar me here nga ISHPK-ja.

Gjykata dëshminë e këtij dëshmitari, nuk e ka vlerësuar pasi që ka të bëjë me të akuzuarin A.K për të cilin është veçuar procedura penale.

Gjykata në rishqyrtimin gjyqësor të datës 09.01.2024 me propozimin dhe pëlqimin e palëve ka lexuar dëshminë e dëshmitarit F.L, të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të kaluar, ku kishte deklaruar se dëshmitari bashkëpunues B.M, i cili në seancën e datës 14.03.2022 ka deklaruar se ”atë vendim e kam prit si vendim të drejtë, av. F. me ka pyetur, kush ta ka kryer këtë punë, unë i kam tregu dhe i njëjti me ka thënë se A.i nuk mundet me krye këtë punë mirëpo unë e njoh personalisht L.in dhe ai ka mund me ta krye këtë punë”, është përgjigjur sa i kujtohet kjo bisede nuk ka ndodhur përpara se mu marr vendimi i Supremes, krejt çka me kujtohet është se ai me ka thënë se është takuar me një shofer edhe se i ka premtuar dikush se ka me i ndihmuar me shume kurrjë nuk dinë për atë çështje. Punën e L.it derisa është arrestuar nuk e ka ditë, nuk e din se a ka diskutu me B.in apo ajo pas arrestimit të L.it, ndërsa përpara nuk ka shanca me diskutu me B.in, as nuk i është kujtuar që ka diskutuar çështjen e L.it me B.in, ndërsa shoferin e dinë që e ka përmend.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, mirëpo e njëjta nuk është relevante lidhur me ngjarjen, dhe si e tillë përmes të njëjtës nuk vërtetohet ndonjë rrethanë e rëndësishme në këtë çështje penale.

Gjykata në rishqyrtimin gjyqësor të datës 09.01.2024 me propozimin dhe pëlqimin e palëve ka lexuar dëshminë e dëshmitarit F.S, të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të kaluar, ku kishte deklaruar se fillimisht mbetet pran deklaratës së dhënë në Prokurori me dt.17.03.2021, për të shtuar se punon në KPK si udhëheqës i zyrës së transportit, përgjegjësia e të cilit konsiston në menaxhimin e transportit, shërbimeve, servistimeve etj, mirëpo nuk është përgjegjës për intinerarin e veturave, përveç që pranon një raport mujor mbi shfrytëzimin e veturave zyrtare nga personat përgjegjës, raportimi i cili është zbehur si rrjedhojë e pandemisë, e në këtë drejtim edhe i akuzuari A. si vozitësi i drejtorit të sekretariatit të KPK-së i ka reduktuar këto raporte, përkatësisht nuk ka paraqit fare raport mbi shpenzimet, intinerarin e ndjekur gjatë kësaj periudhe gjithmonë duke u thirrur në gjendjen e shkaktuar nga pandemia. Ka shtuar se nuk i kujtohet sa kilometra i ka bërë A.i me veturë zyrtare gjatë vitit 2020, mirëpo pas momentit të largimit të tij, me veturë zyrtare nuk kanë bërë itinerar me shumë se 700 km, dhe lidhur me këtë rrethanë është ballafaquar me deklaratën e dhënë në prokurori me dt.17.03.2021, ku kishte deklaruar se gjatë vitit 2020, përkatësisht në muajin Gusht 2970 km, shtator janë 2807 km, Tetor 1000 km, në nëntor 707 km, ndërsa në dhjetor 753 km, për çka dëshmitari është përgjigjur se nuk është kompetencën e tij të shpjegoj se si kanë mundur të bëhen këto kilometra, mirëpo që të gjitha të dhënat e poseduara janë dorëzuar në Prokurorin e shtetit, qoftë sa i përket kilometrave të bëra apo shpenzimeve të krijuara në derivate apo për nevoja tjera. Me tutje ka deklaruar se në raste të udhëtimit jashtë vendi me veturë, shoferi është dashur të i drejtohet me kërkesë, i cila kërkesë nga zyra e dëshmitarit dërgohet në zyrën ligjore, dhe pastaj nënshkruhet nga kryesuesi, dhe lidhur me këtë çështje i është rijetuar pjesa e deklaratës së bërë në prokurori me dt.17.03.2021, ku pasi që është njoftuar me të dhëna nga pikat kufitare VMS sipas të cilave A.K figuron se është kthyer nga Shqipëria me veturën zyrtare ..., kishte deklaruar se nuk është në dijeni për këtë udhëtim, për here të parë po dëgjon dhe është dashur të pajiset me leje për këtë udhëtim, me ç'rast ka pohuar se qëndron pas kësaj përgjigje sepse gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur takime jashtë-vendit. Në deklaratën e dhënë në Prokurori me dt.17.03.2021, ngjashëm ka deklaruar lidhur me rrethanat për të cilat është pyetur, ndërsa që nevojë të sqarimit të rrethanave janë rikujtuar pjesë të caktuara të kësaj deklaratë pran të cilave ka deklaruar se qëndron në tërësi.

Gjykata dëshminë e këtij dëshmitari nuk e ka vlerësuar pasi që ka të bëjë me të akuzuarin A.K për të cilin është veçuar procedura penale.

Gjykata në rishqyrtimin gjyqësor të datës 09.01.2024 me propozimin dhe pëlqimin e palëve ka lexuar dëshminë e dëshmitarit B.L, të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të kaluar, ku kishte deklaruar se është pronar i Kompanisë "G...", që merret me prodhimin e mobileve të ndryshme, kanë aplikuar në tenderi e shpallur nga KPK, aplikimi ka qenë elektronik, me rastin e dërgimit të vërtetimit të gjykatës dhe vërtetimit të ATK-së, sipas kërkesës së autoritetit kontraktues, nga menaxheria e prokurimit F.D i është thënë që nëse nuk të prish punë ty, një pjesë e inventarit ta marr tek kompania "S...", me ç'rast dëshmitari ka shkuar tek kompania "Solo" për të biseduar me të njëjtit dhe kanë rënë dakord për inventarin në shumë prej 5.550 euro, me 5 shkurt 2021 është shpall fitues, kontrata me KPK është nënshkruar me dt.16.02.2021, afati i liferimit ka qenë deri me dt.08.03.2021, sa i kujtohet me datë 1 ose 2 mars 2021 është thirrur nga policia e cila i ka kërkuar faturat, të cilat kanë qenë të pa proktokolluara meqenëse ka pasur afat për këtë, dhe me at rast është njoftuar nga Policia se kompania "Solo" kishte dërguar inventarin për të cilin kishin rënë dakord, që sa i kujtohet ka qenë kolltukët dhe tavolina, dhe sipas kërkesës së Policisë

ka kontaktuar me kompaninë “Solo”, e cila i ka pohuar se mobiliet ishin dërguar me rreth datës 17-18 ose 19 shkurt 2021. Ka theksuar se në këtë rast ka qenë e drejta e tij, për mënyrën se si i siguron mobiliet, i prodhon vetë apo i merr dikund tjetër, me rendësi është i ju përmbajt kontratës, dhe në rastin konkret ka vepruar kështu. Dëshmitari ngjashëm ka deklaruar edhe në deklaratat e dhëna në procedurën paraprake,, pran të cilave ka deklaruar se qëndron në tërësi, përkatësisht deklaratës së dhënë në Polici me dt.07.04.2021 dhe në prokurori me dt.28.04.2021, ku ka përshkruar ofertimin në tender, Furnizim me mobileje ekskluzive për kabinetin e ... të Republikës së Kosovës me nr.identifikues PSH250-021-001-136”, përzgjedhjen si fitues me çmimin e ofertuar prej 9.480 euro, dakordikim me kompaninë “Solo”, që produktet nga numri 1 deri numrin 8, të dërgohen nga e njëjta, pastaj, faktin edhe pse janë dakorduar që produktet të dërgohen pas njoftimit paraprak nga dëshmitari për kohën e dërgimit të tyre, janë dërguar pa njoftimin e tij, dhe siç i është thënë janë dërguare në javën e tret të muajit shkurt, ndërsa që mobiliet tjera nga numri 9 deri numrin 11, janë dërguar nga kompania “G...”me dt.26.02.2021. Ka theksuar se mobiliet në kompaninë “Solo”, i ka siguruar sipas kërkesës së menaxheres së prokurimit F., mirëpo që kjo edhe i ka leverdisur dhe e ka shfrytëzuar të drejtën e tij që të mos kufizohet nga mënyra e sigurimit të mobileve, duke u siguruar që të jenë sipas kontratës së lidhur me dt. 16.02.2021. në deklaratën e dhënë në prokurori me dt.28.04.2021, përveç këtyre rrethanave, ka përshkruar faktin se në momentin kur ka biseduar me menaxheren e prokurimit F., lidhur me mundësin që mobiliet e caktuara të merren nga kompania “Solo”, s’bashku kanë shkuar në zyrën ku është dashur të vendosen të njëjtat, aty ka parë një asistente apo referente, pastaj ka ardhur një zotëri, si në moshë, të cilit F. i ka thënë se ky do të i sjell mobiliet, ndërsa që ai i është përgjigjur me shpjegim se kemi takim, pastaj e njëjta i ka thënë se po hy po shikoj tek një zyre tjetër se a është drejtori aty, mirëpo pasi që ka folur me një vajzë, ka thënë se i njëjti ishte i zën.

Gjykata ka vlerësuar dhe dëshminë e këtij dëshmitari, të cilën dëshmi e ka gjetur si dëshmi reale, të sigurtë dhe objektive, e nga e cila dëshmi vërtetohet fakti se Kompania “G...”, kishte fituar tenderin Furnizim me mobileje ekskluzive për kabinetin e ... të Republikës së Kosovës me nr.identifikues PSH250-021-001-136”, se kishte qenë kërkesa menaxheres së prokurimit F.D, që nëse nuk i prish punë, një pjesë e inventarit ta marr tek kompania “S...”, mirëpo ka qenë në zgjedhjen e tij ta pranoj ose jo këtë kërkesë, dhe se në këtë zgjedhje nuk mund të ndërhy askush, mjafton që ta përmbush kontratën ashtu siç kërkohet, përtej fakti se ku i gjen produktet e kërkuara, duke vërtetuar kështu se nuk ka qenë i ndikuar dhe as i detyruar në zgjedhjet dhe veprimet e tij, fakti që i është bërë si kërkesë apo lujtje për të mu marr parasys, në asnjë rast nuk ka nënkuptuar siç e ka pohuar dhe dëshmitari, që ka mundur ta refuzoj këtë lloj kërkesë. Siç vërtetohet edhe nga ky dëshmitar, e që dëshmia e tij është në përputhje dhe me dëshmitë e dëshmitareve tjerë dhe provat materiale, oferta nga kompania e tij, ishte zgjedhur si fituese, në një procedurë të rregullt prokurimi, ku pjesëmarrës në tender kishte edhe operator të tjerë, të cilat nuk e kishin kontestuar vendimin e komisionit për vlerësim dhe përzgjedhje, përmes paraqitjes së ndonjë ankese eventuale, në autoritetin përkatës. Sa i përket dorëzimit të mobileve, gjykata gjen dëshmitari i është thënë se dorëzimi i produkteve nga numri 1 deri numrin 8, nga kompania “Solo”, është bërë rreth datës 17-18 ose 19 shkurt 2021, gjë që dëshmitari nuk është sigurt lidhur me vërtitësin e kësaj rrethane, prandaj, dëshmia e tij nuk mund të shërbej për vërtetimin e të njëjtës.

Me propozimin e palëve dhe pëlqimin e tyre janë dëgjuar edhe dëshmitarët

Dëshmitari F.A, në seancën e rishqyrtimit gjyqësor të datës 16.01.2024, ka deklaruar se L.Kn e njoh nga viti 2011 kur kemi filluar të jetojmë në një objekt banesor, në vitin 2020 e kam vlerë një banesë nga ai, ku kemi bërë para kontrate dhe banesën është dashur ta liroj L.i ne qershor te vitit 2021, dhe në tetor të vitit 2020 e kam bërë pagesën prej 40,000 euro, nga ProCredit Bank në Raiffeisen Bank në llogari të L.it, adresa e banesës ka qenë në Mati.1, Kompleksi Dafina, blloku 3/3, kati.6 nr.23 dhe banesën e kam pranuar nga L.i në vitin 2021, kur është lidh para kontrata, shuma e banesës në tërësi ka qenë 65,000 euro, pasi që banesat janë të pa legalizime është bere një para kontratë ku është konsideru valide dhe me të kam aplikuar për kredi në bankë për me paguar banesën, pas legalizimit do të bëhet kontrata kryesore, unë i'a kam bërë pagesën në shumën prej 40,000, ndërsa pjesën tjetër shumën prej 25,000 euro kam pas me i'a pagu në vitin 2021, mirëpo pasi që nuk kam pas mundësi me bërë pagesën e kam shtyrë afatin e pagesës deri në fund të vitit 2023, ku e kam paguar gjithë banesën. Në kohën kur është përpilua kjo parakontrat dhe pas saj, në një periudhë në banës ka qëndruar L.K, në parakontratë ka pas kushte nëse e njëjta nuk përmbushet, se nëse shitësi nuk arrin që banesën ta përkthej ne emrin tim i njëjti duhet ti kthej të gjitha parat, banesa ka figuruar në emër te L.it para nënshkrimit të parakontrates dhe pas saj me letra edhe sot figuron në emër të tij.

Dëshmitari A.Z, në seancën e rishqyrtimit gjyqësor të datës 16.01.2024, ka deklaruar se qëndrojë pranë deklaratës së dhënë në prokurori, atëherë e kam përmendë një shumë prej 10,000 euro, e cila ka qenë hua që i'a ka dhënë L.K vëllaut tim A.Z dhe për këtë ka edhe dokumente, pasi që kjo është bërë përmes bankës, për këtë vëllau më ka treguar, pasi që i janë dashur parat.

Gjykata vlerësuar dëshmitë e dëshmitarëve F.A dhe A.Z, të singertë, bindëse dhe e mbështetur në provat tjera, pasi që nga dëshmia e dëshmitarit F.A, gjykata vlerëson se vërtetohet fakti se i pandehuri L. i'a ka shitur banesën dhe shumën prej 40,000 euro i'a ka deponuar në xhirollogari bankare, mirëpo pasi që banesa nuk ka qenë e legalizuar nuk është bërë kontrata kryesore, kjo vërtetohet se këto para ky dëshmitar i ka marr kredi për blerjen e kësaj banese. Po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit A.Z gjykata vlerëson se vërtetohet fakti se shuma prej 10,000 euro të cilat kanë qenë hua që i pandehuri L. i'a ka dhënë mikut të tij, e në këtë rast vllaut të këtij dëshmitari.

Ekspertja e prokurimit publik Blerina Shamolli në ekspertizën e saj për aktivitetin e prokurimit me numër 250-21-236-1-3-6 të datës 12.02.2024 dhe në seancën e rishqyrtimit gjyqësor të datës 14.02.2024 ka deklaruar se duke u bazuar në dispozitat e Ligjit të prokurimit publik, asnjë furnizim, shërbim apo punë nuk mund të ofrohet me ndonjë autoritet kontraktues pa pasur fillimisht procedurën e prokurimit dhe sipas dokumentacionit të ofruar nga autoriteti kontraktues, datat e pranimi të mallit, gjithmonë sipas raportit të komisionit të pranimi prej 3 anëtarëve dhe sipas raportit të menaxherit të projektit janë kryer pas inicimit të një procedure të prokurimit, gjithmonë bazuar vetëm sipas dokumentacionit të prezantuar. Kjo d.m.th., se ka pasur një njoftim për kontratë, dosja e tenderit, procedura deri në nënshkrimin e kontratës dhe pranimi i mallit, ndërsa pjesa e faturës siç është e përmendur në disa pika të ekspertizës nuk është e sqaruar, për shkak se kjo faturë në departamentin e financave nuk është e dorëzuar asnjëherë sipas konfirmimit në email nga zyrtarja e financave dhe për më tutje, për të sqaruar këtë situatë është e kërkuar akses që fatura e dorëzuar në arhivë, tek cili zyrtar përgjegjës është dorëzuar. Për shkak se përgjegjësja e arhivës ka qenë në pushim mjekësor edhe pas një afati të caktuar për përgjigje, mendoj se nuk mund të konsiderohet si përgjigje e marrë, për shkak të caktimit të seancës më datë të sotme. Ndërsa, kolegët e arhivës, në të cilën zyre kam qenë prezentë fizikisht, gjithashtu edhe pas njoftimit nuk kanë kthyer ndonjë përgjigje.

Lidhur me këtë pikë, edhe menaxheri i projektit, i cili ka mundur të sqarojë situatën është ndodhur gjithashtu në pushim pa pagesë, që d.m.th. përpos pjesës së pagesës së faturës, e gjithë procedura e prokurimit është e iniciuar sipas dispozitave të Ligjit të prokurimit. Përgjegjësitë e zyrtarit kryesor administrativ sipas Ligjit të menaxhimit të financave publike, po ashtu sipas Ligjit të prokurimit publik janë në kompetenca të tij që të sigurojë që organizata buxhetore – Agjencia autonome ekzekutive ose autoriteti kontraktues – Këshilli prokurorial të jenë në përputhje të plotë dhe të respektojë dispozitat e dy ligjeve të sipër përmendura. Sipas përgjegjësive të ZKA është personi përgjegjës i cili inicion procedurën e prokurimit, duke iniciuar kërkesën e zotimit të mjeteve, që më pas sipas hierarkisë dorëzohen tek zyrtari autorizues të nënshkruar nga vetë ai dhe zyrtari financiar për të kaluar në zyrën e prokurimit, gjithashtu, është përgjegjës për verifikimin e gjithë procedurës deri në përfundimin e saj. Në rastin konkret, personi zyrtar e ka nënshkruar kërkesën për furnizimin me mobile të kabinetit të kryesuesit, ku njëkohësisht edhe z. L. është person autorizues për iniciimin e kësaj kërkesë të prokurimit. Procedura e prokurimit lidhur me këtë çështje është zhvilluar Konform dispozitave ligjore të prokurimit dhe në bazë të dokumentacionit nuk ka pasur shkelje lidhur me zhvillimin e procedurës së tenderimit.

Gjykata ka vlerësuar ekspertizën e prokurimit publik dhe deklarimin e ekspertes Berina Shamolli të dhënë në rishqyrtim gjyqësorë, të njëjtës gjykata i'a ka falë besimin pasi që e njëjta e ka sqaruar në tërësi procedurën e prokurimit që ka të bëjë pikën V të aktakuzës, e cila ka sqaruar se gjatë procedurës së prokurimit, se gjithçka ka shkuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore të parpara me ligjin e prokurimit publik dhe nuk ka pasur asnjë shkelje ligjore, gjithashtu mobilet janë pranuar pas nënshkrimit të kontratës, e njëjtë ekspertizë është bindëse dhe mbështet dhe në provat si ato personale e që janë dëshmitë e dëshmitarëve E.SH, L.D, V.C dhe I.H dhe provat materiale të cilat janë administruara në këtë rishqyrtim gjyqësor.

Nga Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë me numër PKR.712/2015 i dt.28.12.2018, vërtetohet se B.M është dënuar për veprën penale Vrasje në tentativë nga nenin 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së me dënim me burgim prej 3 viteve, për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga nenin 188 par.1 lidhur me par.1 pika 4 të KPRK-së me dënim me burgim prej 1 viti, për veprën penale Asgjësimi apo dëmtimit i pasurisë nga neni 333 par.1 i KPRK-së me dënim prej 3 muaj burgim, dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, me dënim me burgim prej 6 muajve. I është shqiptuar dënim me burgim unik në kohëzgjatje prej 4 viteve e 6 muaj.

Nga Aktgjykimi i Gjykatës se Apelit me numër PKR me numër. 134/19 te datës 05.04.2019 vërtetohet se kjo gjykatë, e ka ndryshuar vendimin e shkalles së parë sa i përket vendimit mbi dënim ashtu që për veprën penale Asgjësimi apo dëmtimit i pasurisë nga neni 333 par.1 i KPRK-së i ka shqiptuar dënim me gjobë prej 1000 euro, për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dënim me gjobë në lartësi 1000 euro. I ka shqiptuar dënim unik me burgim 3 vite e 7 muaj dhe dënim Unik me gjobë 2.000 euro.

Nga Përgjigje në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, me nr. KMLP.nr.128/19 e datës, 17.06.2019, vërtetohet se në përgjigjen e paraqitur nga zyra e Kryeprokurorit të shtetit, është kërkuar refuzimi i kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga mbrojtësi i të gjykuarit B.M, av.Florent Latifi, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë me numër

PKR.712/2015 i dt 28.12.2018 dhe Aktgjykimi i Gjykatës se Apelit me numër PKR me numër. 134/19 te datës 05.04.2019.

Nga Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, me nr. Pml.nr.178/2019 i datës, 02.07.2019, vërtetohet se kjo gjykatë ka miratuar pjesërisht kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, me nr. KMLP.nr.128/19 e datës, 17.06.2019, ashtu që ka vendosur qe për veprën penale Vrasje në tentativë nga nenin 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, të anulohet aktgjykimet e gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Nga Kërkesa për interpretim të aktgjykimit, drejtuar Gjykatës Supreme e datës, 19.09.2019, vërtetohet se përmes të njëjtës është kërkuar interpretimi Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, me nr. Pml.nr.178/2019 i datës, 02.07.2019, me arsyetimin se është e paqartë se si duhet të veprohet meqenëse lënda është kthyer në rivendosjes, derisa që për të dënuarin B.M është lëshuar urdhëresë mbi ekzekutimin e dënimit.

Nga Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit e datës, 08.12.2020, vërtetohet se përmes të njëjtës i dënuarit B.M i është drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës me kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, duke pretenduar se ekzistojnë rrethanat që kërkesa e tij të miratohet.

Gjykata ka vlerësuar, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë me numër PKR.712/2015 i dt 28.12.2018; Aktgjykimi i Gjykatës se Apelit me numër PKR me numër. 134/19 i dt.05.04.2019; Përgjigje në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, me nr. KMLP.nr.128/19 e dt.17.06.2019; Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, me nr. Pml.nr.178/2019 i dt.02.07.2019; Kërkesa për interpretim të aktgjykimit, drejtuar Gjykatës Supreme e dt.19.09.2019; Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit e dt.08.12.2020; e nga të cilat ka vërtetuar rrethanën se tani dëshmitari bashkëpunues B.M ka qenë i akuzuari dhe pastaj i dënuar për të tri vepra penale, të përshkruar si më lartë, ndërsa që në Gjykatën Supreme si gjykata e shkallës së tretë, është vendosur që lidhur me veprën penale Vrasje në tentativë nga nenin 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, lënda të i kthehet në rigjykim, dhe se koha e vendosjes rezulton data 02.07.2019, gjë që nuk është përputhje me datën dhe kohen që përshkruan dëshmitari bashkëpunues B.M, i cili ka përmendur muajin mars-prill, se kohen kur është takuar, ka biseduar dhe ka marr premtimin nga i akuzuari A.i se do ndikoj në vendosjen e kësaj lënde në Gjykate Supreme, dhe se për një, dy apo tri ditë meqenëse vetë dëshmitari numrin e ditëve e ka ndryshuar vazhdimisht, nga kjo bisedë është njoftuar se Gjykata ka vendosur në favor të tij.

Nga Kontrata për shitblerjen e veturës LRP:16008/12, Ref:3464/19, e datës 16.12.2019, vërtetohet se e njëjta është lidhur në mes të “Te H.” shpk, i përfaqësuar nga B.M - shitës dhe M.B – blerës, çmimi i shitjes është 7.000 (shtatë mijë) €, objekt i shitjes është veturë e tipit “VË-T-ROC”, vitit i prodhimit 2018, me ngjyrë të bardhë, me tabela të regjistrimit ....

Nga autorizimi për përdorim të automjetit dhe Përfaqësim Nr.i LRP.:15995/2019 i dt.16.12.2019 vërtetohet se “Te H.: sh.p.k” e ka autorizuar B.Mn që veturën Volksëagen-VË, Tipi: A1-T-ROC, viti i prodhimit 2018 dhe me numër të shasisë: ËVGZZZA1ZJV109488, të mund ta shesë, ta inkasoj çmimin e shitjes si dhe të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme gjatë gjithë kohës që vlen ky autorizim.

Gjykata ka vlerësuar edhe Kontratën për shitblerjen e veturës LRP:16008/12, Ref:3464/19 dhe autorizimi për përdorim të automjetit dhe Përfaqësim Nr.i LRP.:15995/2019 i dt.16.12.2019, nga



të cilat ka vërtetuar se Kontratën për shitblerjen e veturës Volkswagen-VË, Tipi: A1-T-ROC, viti i prodhimit 2018, ishte lidhur ndërmjet B.Mt si shitës me autorizim nga pronari “Te H.” shpk, dhe M.B – blerës, pra nënshkruer i kontratës është vetë dëshmitari bashkëpunues B.M, dhe çmimi i deklaruar në kontratë është 7.000 (shtatë mijë) €, se kontrata është lidhur pran noterit dhe pas sigurimit paraprak se palët kanë dijeninë dhe vullnetin për të hyr në drejta dhe detyrime reciproke, se në kuadër të kësaj kontrate nuk është konstatuar ndonjë kusht, nga i cili do varej realizimi i ndonjë detyrimi.

Nga Marrëveshja mbi kredinë për persona Fizik nr.261060 e dt.12.12.2019 vërtetohet se e akuzuari M... Berisha në cilësinë e kredi marrëses dhe Haxhere Berisha në cilësinë e bashkëkredimarrëses, kanë marr nga TEB SH.A, në cilësinë e kredi dhënësit, shumë prej 17.000.00 euro, me periudhë maturimi 84 muaj. Kredia është marr për renovim dhe blerje të veturës.

Nga urdhër pagesa kombëtare ref.nr.940273 e dt.16.12.2019, vërtetohet se nga xhirollogaria e M... Berisha në Bankën “TEB SH.A.” me nr.20-34-000-1759309-91 është transferuar shuma prej 7.000.00 në xhirollogarinë me nr. 1501040002548023 në bankën “Raiffeisen Bank”, në emër të B.M.

Nga Konfirmimin bankar i dt.05.10.2021 i lëshuar nga Banka “TEB” vërtetohet se në të njëjtin është konstatuar se transferi i dt.16.12.20219 është kthyer mbrapa nga RBKO (paguar nga dërgesa hyrëse me përshkrim orgndate/20191217/orgnref/7479413/rsn/ërong name B.M), dhe transferi prap është ekzekutuar me date 18.12.2019 në RBKO. Të njëjtës i është bashkangjitur gjendja e llogaris 20-34-0001759309-91 për periudhën kohore 10.12.2019-31.12.2019, në të cilën pasqyrohet se me dt.12.12.2019 në xhirollogarinë e të akuzuarës M... është transferuar shuma prej 17.000 euro në emër të marrjes së kredisë. Me dt.16.12.2019 e akuzuara M... ka tërhequr nga llogaria shumën prej 10.000 euro, ndërsa që po në të njëjtën datë është transferuar shuma prej prej 7.000.00 në xhirollogarinë me nr. 1501040002977927 në bankën “Raiffeisen Bank”, në emër të B.Mt, po ashtu me dt.18.12.2019, rezulton se është përsëritur i njëjti veprim.

Nga fletëpagesat e dënimeve të gjobave të shqiptuara ndaj I.S si pronar i automjetit, është shqiptuar një gjobë për trafik, A.Mt një gjobë në shumë prej 300 euro; në emër të B.M, 4 gjoba në shumë totale prej 260 euro.

Nga urdhër pagesa kombëtare ref.nr.941083 e dt.18.12.2019, vërtetohet se nga xhirollogaria e M.B në Bankën “TEB SH.A.” me nr.20-34-000-1759309-91 është transferuar shuma prej 7.000.00 në xhirollogarinë me nr. 1501040002977927 në bankën “Raiffeisen Bank”, në emër të B.Mt.

Gjykata ka vlerësuar edhe Marrëveshja mbi kredinë për persona Fizik nr.261060 e dt.12.12.2019; urdhër pagesa kombëtare ref.nr.940273 e dt.16.12.2019, Konfirmimin bankar i dt.05.10.2021 i lëshuar nga Banka “TEB”; urdhër pagesa kombëtare ref.nr.941083 e dt.18.12.2019, dhe fletëpagesat e dënimeve të gjobave, nga të cilat prova ka vërtetuar fakti se e akuzuar M... disa ditë para se të lidhte Kontratën për shitblerjen e veturës Volkswagen-VË, Tipi: A1-T-ROC, viti i prodhimit 2018, ka arritur Marrëveshja për marrje të kredisë në shumë prej 17.000.00, të cilën kredi vetë e akuzuara ka deklaruar se ka marr për qëllim të blerjes së veturës, gjë që është në përputhje me kohën e marrjes së të njëjtës, por edhe vetë qëllimit të deklaruar në marrëveshje, se kredia merret edhe për blerje të veturës. Dhe pastaj nga e njëjta xhirollogari,

shuma prej 7.000 euro i është transferuar në xhirollogarinë e tani dëshmitarit bashkëpunues B.M, çka vërteton se pikërisht kjo shumë e parave rrjedhë nga kredia e marr, nga tani e akuzuara M... dhe se në emër të gjobave të shqiptuar për personat që kanë drejtuar këtë automjet në shkelje të rregullave të trafikut, ka paguar shumën prej 600 euro, ndërsa që po ashtu pas marrjes së kredisë, shuma 10.000 euro është tërhequr nga xhirollogaria nga e akuzuara M. që është në përputhje me pohimin e saj se pjesa tjetër e pagesës i është kryer në kesh.

Nga Deklarata e datës 16.12.2019 vërtetohet se në të njëjtën figuron nënshkrimi i B.M dhe të pandehurës M.B, ndërsa që në përmbajtje është konstatuar se B.M ka deklaruar se në emër të shitjes së veturës “VË-T-ROC”, vitit i prodhimit 2018, ka pranuar kesh shumën e parave prej 8,400.00 euro nga M.B, ndërsa që shuma prej 7.000.00 euro i është transferuar në xhirollogari Bankare. Pastaj se M... Berisha ka paguar shumën prej 600.00 euro dënime kundervajtëse në emër të kësaj veture, ashtu që çmimi total i blerjes është 16.000.00 euro.

Nga Raporti i ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, me nr. AKF/2021-0908/2021-850 e datës, 21.04.2021, vërtetohet se në të njëjtin është konstatuar se gjatë ekspertimit të nënshkrimeve në dokumentet e evidentuara në dëshminë D# si dhe krahasimit me nënshkrimet në dokumentet e evidentuara në dëshmitë D#1.1 dhe D#2 janë identifikuar karakteristikat të përgjithshme dhe individuale që nuk përputhen më mes tyre. Karakteristike këto dalluese që konsistojnë në pozicionin e pikës së fillimit të nënshkrimit si dhe drejtimi i vazhdimet të tij, mënyra e formulimit të elementeve në vazhdimësi si dhe drejtimi i dorës gjatë formimit të pjesës së fundit.

Gjykata ka vlerësuar edhe Deklarata e datës, 16.12.2019 dhe Raportin e ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, me nr. AKF/2021-0908/2021-850 e datës, 21.04.2021, lidhur me këtë deklaratë, nga e cila ka vërtetuar se nënshkrimi i cili figuron në këtë deklaratë se kinse është nënshkuara nga B.M, është falsifikuar, pra se i njëjti nuk e ka nënshkruar asnjëherë këtë deklaratë, përkatësisht se e njëjta është përpiluar nga vetë e akuzuara M..., ani pse në përmbajtjen e saj, është në përputhje me provat tjera siç është shuma e paguar përmes xhirollogarisë bankare në emër të B.Mt, si dhe lidhur me shumën e gjobave që ka paguar në emër të veturës që ka blerë. Mirëpo që përkundër këtyre rrethanave, tanimë bindshëm është vërtetuar se nënshkrimi në emër të B.Mt është falsifikuar.

Nga Raporti i ekspertit financiar Nr.ref.06/1-02/033-2021 i dt.30.04.2021, lidhur me të akuzuarit L.K për periudhën kohore 2003-2021, dhe M... Berisha për periudhën kohore 2011-2021, vërtetohet se në të njëjtin janë paraqitur qarkullimi i mjeteve financiare në xhirollogaritë e këtyre të akuzuarve, hyrje-daljet e realizuara, pastaj deponimet e mjeteve, burimi i këtyre mjeteve, arsyeja e hyrje daljeve dhe deponimeve të kryera. Lidhur me të akuzuarin L.K vërtetohet se i njëjti ka bërë transferimin e mjeteve nga nr. llogaris ..., në emër të A.Z në shumë prej 10.000.00 euro, në emër të huadhënies, e cila vërtetohet dhe nga dëshmitari A.Z dhënë në shqyrtim gjyqësor.

Pastaj për të njëjtin është evidentuar transferim me datë 19.10.2020 i shumës së të hollave prej 40.000 (dyzet mijë) €, të cilat i ka pranuar nga F.A për shitjen e banesës ... Kompleksi Dafina Mati 1 sipas para kontratës me dt.13.10.2020, në llogarinë bankare ..., në ProCredit Bank.

Po ashtu vërtetohet transferimi i mjeteve vepër B.M nga nr.xhirollogaris ..., në emër të M... Berisha, shuma prej 7.000.00 euro, në emër të blerjes së veturës “VË-T-ROC”.

Nga raporti informues i policisë për zbulimin e te dhënave financiare nr.ref.2021-KE-50 i dt.20.05.2021 vërtetohet se në të njëjtin janë paraqitur të dhënat financiare të cilat janë siguruar në institucionet financiare, shërbimet e të cilave i kanë shfrytëzuar të akuzuarit L.K, dhe M.B, për kryerjen e transaksioneve financiare, deponime, tërheqje, pagesa të ndryshme, huazime dhe kthim të huazimeve.

Gjykata ka vlerësuar edhe Raporti i ekspertit financiare Nr.ref.06/1-02/033-2021 i dt.30.04.2021 dhe raportin informues të policisë për zbulimin e te dhënave financiare nr.ref.2021-KE-50 i dt.20.05.2021, e nga e cila ka vërtetuar bindshëm faktin se shuma e transferuar nga L.K për A.Z ka qenë në emër të huadhënies, gjë që është në përputhje me komunikimin përmes email-it të, dhe shqyrtimin gjyqësor A.Z e konstaton faktin se mjetet i ka pranuar si huadhënie, nga L.i ,pastaj po i akuzuari L.K me dt.09.10.2020 në xhirollogarinë e tij bankare ka pranuar shumën e të hollave prej 40.000 (dyzet mijë) €, nga shitja e banesës, shumë të cilën nuk e ka deklaruar në formularin për deklarimin e pasurisë për vitin 2020, ndërsa që nisur nga koha kur ka pranuar në xhirollogari kjo mjete dhe kohës kur bërë dorëzimin e formularit për deklarim të pasurisë në fund të muajit mars 2021,

Po ashtu vërtetohet dhe transferimi i mjeteve financiare nga e akuzuara M... në xhirollogarinë e B.Mt, në emër të blerjes së veturës, nga i njëjti.

Nga formulari për deklarimin e pasurisë i dorëzuar në Agjencinë kundër Korrupsionit, në emër të L.Kt me dt.31.03.2021, vërtetohet se në të njëjtin është deklaruar pasuria e paluajtshme dhe atë banesa me sipërfaqe 59m2 dhe garazha me Depo në sipërfaqe prej 20.46 m2, në adresën Mati 1, Kompleksi Dafina në Prishtinë, dhe toka në fshatin ... në K-Malishevë në sipërfaqe 70.0 m2, pastaj para të gatshme në Bankën Raifeisen në shumë prej 16,877.67 euro, shumën e huazuar për A.Z në lartësi prej 10.000.00.

Nga bisedat në whatsapp e të akuzuarit L.K, vërtetohet se i njëjti me dt.26.02.2021, ka biseduar me te pandehurin A.K, të cilit i ka shkruar në ora 11:58:35 “A. a mundësh mem kallxu se çka ke ba se njeri me ke mbet ne dere”; në ora 11:58:48 “se njeri me ka mbet në dere”, në ora 12:00:36 “Kallxom pash at zot”. Po ashtu ka biseduar me personin me emrin L., me dt. 06.11.2020, pastaj me dt. 06.12.2020; 09.07.2020. Gjykata ka vlerësuar edhe këtë prove materiale, e nga e cila ka vërtetuar se i akuzuari L. i ka kërkuar shpjegime të akuzuarit A. mbi raportet me tani dëshmitarin bashkëpunues B.M, pasi që ky i fundit kishte shkruar tek i akuzuari për të kërkuar llogari nga i njëjti, me çka rezulton se i akuzuari L. nuk ka qenë në dijeni mbi veprimet e të akuzuarit A., dhe raporte apo natyrën e raporteve me dëshmitarin bashkëpunues B.M, përndryshe nuk do kishte një reagim të tillë i akuzuari L., nëse vërtet i njëjti do kishte qenë në dijeni dhe për me tepër të kishte ndonjë raport të asaj natyre që shprehimisht apo me sjellje konkludente të krijonte pritje tek dëshmitari bashkëpunues se vërtet do i kryente ndonjë punë në kuadër të problemeve të shumtë që dëshmitari bashkëpunues B.M kishte me ligjin, për vete apo familjar të tij. Një reagim i tillë, jo vetëm përjashtoi dhe nuk vërtetoi faktin e ekzistimit të ndonjë raporti të akuzuarit L. me dëshmitarin bashkëpunues B.M mirëpo nga kjo bisedë nuk rezulton as dijenia e të akuzuarit L. lidhur me ekzistimin e ndonjë raporti të të akuzuarit A. me të akuzuarin B..

Nga dosja e tenderit e titulluar “Furnizim me mobileje ekskluzive për kabinetin e ... të Republikës së Kosovës me nr.identifikues PSH250-021-001-136” vërtetohet se e njëjta përbehet nga tri pjesë dhe informacioni për tenderuesit ku janë përfshirë emri i autoritetit kontraktues-Këshilli Prokurial i Kosovës, qëllimi i kontratës “Furnizim me mobileje ekskluzive...”, kërkesat që duhet të i përmbushin operatorët ekonomik, pastaj koha e hapjes së ofertave, kriteret për dhënien e kontratës, pastaj specifikat teknike të detyrueshme, që janë ndarë në numra rendor, ashtu që janë kërkuar (1) 7 korrika statike; (2)një tavolin për takime; (3) tri fotele; (4) tavolin anësore me konstruksion metalik; (5)karrik statike për takim me ulje të butë; (6)tavolin e kafes në form rrethore; (7) tavolin anësore në formë rrethore; (8)një karrik ekzekutive me shpin të lartë, (9) dy dollapa 80cmx200 cm; (10) një dollap 40cm x 200xm; (11) një dollap 80 cm x 200 cm. Po ashtu pjesë e dosjes së tenderit është edhe kërkesa për iniciimin e procedurës për Furnizim me mobileje ekskluzive për kabinetin e ... të Republikës së Kosovës, e cila mban datën 27.01.2023, që është iniciuar nga L.D-zyrtare ligjore, pastaj Formulari i dt.27.01.2021, për disponueshmërinë e mjeteve për kontratën “Furnizim me mobileje ekskluzive për kabinetin e ... të Republikës së Kosovës me nr.identifikues PSH250-021-001-136”, i nënshkruar nga pandehuri L.K në cilësinë e zyrtarit kryesor administrativë dhe N.Q në cilësinë e zyrtares Kryesore Financiare.

Nga Kërkesa për mallra dhe shërbime me numër të kërkesë 2021-39 26 vërtetohet se kërkesa është bërë për furnizimi me mobileje, çmimi i mobileve është përcaktuar 9.480.00 euro,

Nga urdhër blerjet e datës 16.02.2021, vërtetohet se numri i urdhër blerjes është 2021-3926 dhe është lëshuar për pagesën e shumës prej 9.480 euro. Është nënshkruar nga menaxheria e prokurimit F.D dhe nga përfituese B.L.

Nga kontrata e lidhur me operatorin ekonomik dt.16.02.2021, vërtetohet se e njëjta është lidhur për realizimin e projektit “Furnizim me mobileje ekskluzive për kabinetin e ... të Republikës së Kosovës me nr.identifikues PSH250-021-001-136”, në mes Këshillit Prokurial të Kosovës si autoritet kontraktues dhe “G...” sh.p.k, me çmim 9,480.00 euro, me periudhë zgjatje dt.08.03.2021. nënshkruet të kontratës janë: F.D si udhëheqëse e Divizionit të prokurimi dhe D.L menaxher i kompanisë “G...” sh.p.k.

Nga Raporti i komisioni mbi pranimin e mallrave dt.05.03.2021, vërtetohet se në të njëjtin janë konstatuar si të pranuar shtatë korrika statike; një tavolinë për takime; tri fotele; një tavolinë anësore me konstruksion metalik; dy karrik statike për takim me ulje të butë; një tavolinë e kafes në formë rrethore; një tavolinë anësore në formë rrethore; një karrik ekzekutive me shpin të lartë, dy dollapa 80cmx200 cm; (10) një dollap 40cm x 200xm; një dollap 80 cm x 200 cm. Raporti është nënshkruar nga E.SH dhe V.C.

Nga email-i i dt. 25.01.2001 me titull kërkesë për lejimin e zhvillimit të procedurave të prokurimit për furnizim me inventar ekskluziv për zyre, i dërguar nga F.D në cilësinë e udhëheqëses së Divizionit të Prokurimit në KPK, për B.R, vërtetohet se është kërkuar nga të lejohet zhvillimi i procedurës se prokurimit me koutim çmimi, meqenëse kontrata aktuale e nënshkruar me AQP, nuk përmban standardet ekskluzive të kërkuara për nivelin e zyrës së Kryesuesit të KPK-së.

Nga email-it e dt.26.01.2021 i dërguar nga B.R në cilësinë e ... të Agjencisë Qendrore të Prokurimit Publikë, vërtetohet se në të njëjtin është konstatuar se në rast se inventari në karakteristikat e tij dallon nga kontrata kornizë për inventar zyrtar, atëherë lejohet që këtë aktivitete ta zhvillon Këshilli Prokurorial,

Nga Kërkesa për zotim për blerje te datës 15.02.2021, vërtetohet se e njëjta është parqitur nga L.D-zyrtare ligjore, për N.Q udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa në Sekretariatit e KPK-së, e me të cilën është kërkuar zotimi i mjeteve për furnizimi me mobileje ekskluzive për kabinetin e kryesuesit të KPK-së, në shumë prej 9,480.00 euro.

Gjykata ka vlerësuar edhe dosjen e tenderit e titulluar “Furnizim me mobileje ekskluzive për kabinetin e ... të Republikës së Kosovës me nr.identifikues PSH250-021-001-136”; kontratën e lidhur me operatorin ekonomik dt.16.02.2021; Raportin i komisioni mbi pranimin e mallrave dt.05.03.2021; email-i i dt. 25.01.2001; email-it e dt.26.01.2021; Kërkesën për mallra dhe shërbime me numër të kërkesë 2021-39 26; urdhër blerjet e datës 16.02.2021; Kërkesa për zotim për blerje te datës 15.02.2021, nga të cilat prova ka vërtetuar se procedura e prokurimit kishte filluar pas përgjigjes miratuese që kishte marr zyra e prokurimit nga Agjencia Qendrore e Prokurimit lidhur me mundësin e hapjes së procedurave të tenderimit për furnizim me mobilie, çka vërteton faktin se ishte kërkuar leja paraprake nga ky institucion, dhe se mobilit e kërkuara kishin specifikat që nuk ishin përfshirë në tenderin i cili tanimë ishte në zbatim e sipër me një operator tjetër ekonomik, dhe vetëm pas pranimit të përgjigjes, është vazhduar me procedurën e tenderimit, lidhjen e kontratës me operatorin ekonomik “G...”, kur në cilësinë e ofertuesve kishte pasur edhe operator tjerë ekonomik, të cilët nuk janë përzgjedhur, si operator fitues dhe se nuk rezulton se nga këta ofertues të ishte ngritur ndonjë dyshim apo pretendim lidhur me procedurën e zhvilluar, ndikimin apo përzgjedhjen e operatorit fitues, nisur nga rrethanat që nuk lidhen me kriteret e tenderimit, e që kjo vërtetohet dhe nga fakti se nga këta operator/ofertues nuk është paraqitur ndonjë ankesë, ku do kontestohet përzgjedhja e fituesit, fakti që është predikuar ndonjë rrethanë apo veprim, dhe kështu është favorizuar në raport me pjesëmarrësit tjerë në procedurën e tenderimit.

Nga Vendimit me nr.pro DPSKPK -83/2021 i dt.05.03.2021, vërtetohet se përmes të njëjtit është bërë ndryshimi i vendimit Nr.DPSKPK/66/2021 i dt.19.02.2021, ashtu që në vend të anëtares M.B në Komisionin për pranimin e projektit “Furnizim me mobileje ekskluzive për kabinetin e ... të Republikës së Kosovës me nr.identifikues PSH250-021-001-136”, është emëruar V.C.

Nga Vendimin e KPK-se, me numër pro DPSKPK/71/2021 dt.24.02.2021, vërtetohet se është vendosur shfuqizimi i vendimit NR.Prot DPSKPK/63 2021 i datës 19.02.2021, dhe është obliguar divizioni i burimeve njerëzore në kuadër të KPK-së zbatimin e të njëjtit. Vendimi është nënshkruar nga L.K në cilësinë e ... të Sekretariatit të KPK-së.

Nga Kërkesën për shlyerjen e detyrimeve dt.08.03.2021 vërtetohet se nga I.H në cilësinë e menaxherit të kontratës “Furnizim me mobileje ekskluzive për kabinetin e ... të Republikës së Kosovës me nr.identifikues PSH250-021-001-136”, është kërkuar shlyerja e detyrimeve ndaj operatorit ekonomik “G...” SH.P.K, sipas faturës FAT 029/21 e dt.03.03.2021 në shumë prej 9,480.00 euro.

Nga Fatura për pagese të datës 03.03.2021 e cila nga KPK është pranuar me dt.08.03.2021 vërtetohet se operatorit ekonomik "G..." SH.P.K, ka kërkuar pagimin e shumës prej 9,480.00 euro, ashtu që në faturë është bërë përshkrimi i mallit-mobileve të pranuar, sasia dhe shuma për gjithsecilën veç e veç dhe gjithashtu shuma në tërësi.

Nga Raporti për pranim të shërbimeve nga menaxheri i kontratës i dt.08.03.2021, vërtetohet se në të njëjtin është konstatuar se operatori ekonomik "G..." SHPK, e ka përmbushur në tërësi kontratën "Furnizim me mobileje ekskluzive për kabinetin e ... të Republikës së Kosovës me nr.identifikues PSH250-021-001-136", dhe është kërkuar pagesa e faturës me numër FAT 029/21 e dt.03.03.2021 në shumë prej 9,480.00 euro.

Gjykata ka vlerësuar edhe Vendimin me nr.pro DPSKPK -83/2021 i dt.05.03.2021; Vendimin e KPK-se, me numër pro DPSKPK/71/2021 dt.24.02.2021; Kërkesën për shlyerjen e detyrimeve dt.08.03.2021; Fatura për pagese të datës 03.03.2021; Raporti për pranim të shërbimeve nga menaxheri i kontratës i dt.08.03.2021, nga të cilat ka vërtetuar se në raportin pranues nga komisioni për verifikimin e përmbushjes së kontratës, ishte konstatuar se të gjitha artikujt janë pranuar sipas specifikave dhe në sasinë e kërkuar sipas kontratës në momentin kur është përpiluar raporti, për çka edhe operatorit ekonomik i ka lindur e drejta, për paraqitjen e kërkesave për pagesën e shumës në emër të përmbushjes së kontratës. Pra vërtetohet bindshëm fakti se kontrata ishte përmbushur në tërësi, se pagesat janë kryer vetëm pas pranimit të raportit nga komisioni, anëtarët e të cilit komision edhe janë dëgjuar në këtë çështje penale, e që të gjithë kanë dëshmuar se raporti është përpiluar pas janë sigluara se kontrata është përmbushur në tërësi, se artikujt janë pranuar në specifikat dhe sasinë e kërkuar.

Nga kontrata për ndërtim të përbashkët Nr.LRP.8235/2016 dhe Nr.i Ref.1395/2016 e dt.03.10.2016 dhe aneks kontrata për ndarjen njëjësive ndërtimore nga ndërtimi i përbashkët nr.i LRP.4654/2018 dhe Nr.i Ref.983/2018 e dt.04.05. 2018, vërtetohet se A.Z në cilësinë e pronarit të tokës dhe Pozhegi Brothers shpk, në cilësinë e investitorit kanë lidhur kontrata e me sipërme, për ndërtim të përbashkët dhe ndarje të njëjësive banesore, në katet dhe sipërfaqet e përshkruara si në ankesë kontratën e lartcekur, përkatësisht në 3 banesa në objektin C11/B/23; garazhet në objektin C11/B/23; 2 depo në objektin C11/B/23.

Nga përgjigja e Drejtorisë Kadastrale të Komunës së Prishtinës e dt.20.05.2021 vërtetohet se përmes të njëjtës është bërë përshkrimi i historiatit të për parcelën kadastrale nr.826-10, e cila ka dalur nga parcializimi i parcelës kadastrale nr.826-1 në vitin 2006, dhe pastaj po në të njëjtin vit ka kaluar në emër të A.Z, e cila pastaj është bashkuar me parcela tjera për të themeluar bashkëpronësinë, në bazë të kontratave të noterizuara.

Nga përgjigja e odes së noterëve të Kosovës nr.Ref.20/2021 e dt.30.05.2021 vërtetohet se kësaj përgjigje i janë bashkangjitur aneks kontrata për ndarjen njëjësive ndërtimore nga ndërtimi i përbashkët nr.i LRP.4654/2018 dhe Nr.i Ref.983/2018 e dt.04.05 me shkresat përcjellëse, Kontrata për ndërtim të përbashkët Nr.LRP.8235/2016 dhe Nr.i Ref.1395/2016 e dt.03.10.2016 me shkresat përcjellëse dhe autorizimi për përfaqësim i noterizuar LRP.nr.3230/2017 i dt.6.04.2017.

Nga autorizimi për përfaqësim i noterizuar LRP.nr.3230/2017 i dt.6.04.2017 vërtetohet se A.Z e ka autorizuar S.K, për përfaqësim duke e autorizuar që të ketë mundësi të krye të gjitha veprimet me pushet të plot juridik, lidhur me paluajtshmerit e përshkruar si në këtë autorizim.

Nga bisedat në Viber vërtetohet se i pandehurit L.K me dt.18.02.2021 ka biseduar me personin me emër E., bisedën me përmbajtje: E. “sa i përket përfshirjes në çmimin edhe të pjesës ballore nuk kemi mundësi ta bëjmë në kuadër të çmimit pasiqë ka vlerën blerëse pa montim 400-500 euro”, L.i: “...a mund të filloni me matje nesër”, E.: “po mundeim nesër. Ma tregoni adresën në mënyrë që të ju njoftojmë për kohen”, L.i: “Banesat janë te kompleksi Pozhegu Brathers në lagjen e spitalit”. Me dt.20.02.2021 ka biseduar me personin e regjistruar si A.XH Banjo, përkatësisht i ka dërguar disa file, duk e shkruar “kjo është për xhamin e banjos që të thirr”, pastaj është shkruar “adresa lagja e Spitalit, rruga Muharrem Fejza-banesat e Pozhegi Brothers”, ndërsa që personi tjetër i është përgjigjur “në rregull është flm shumë kalo mire”.

Nga komunikimi i te pandehurit L. përmes email me mikun e tij A.Z, me dt.16.02.2021, vërtetohet se A.Z shkruan ”I nderuar L. ne përgjigje te kërkesës suaj për ti blere dy banesa me garazh me te cilat gjenden tek Pozhegu Brother blloku c.11/c.23 Prishtine, e njofton se oferta përfshinë shumen prej 121.280 mije euro, dhe kontrata mund te nënshkruhet kur te vi ne Kosove për shkak te kufizimeve me pandeminë virusit Covid 19. Ju mund te bëni përgatitjen për ti shfrytëzuar banesat dhe garazhin qysh tani ndërsa pas nënshkrimit te kontratës mund ti bëni pagesat sipas marrëveshjes ndërsa shuma prej 10 mije euro që është dhëne vite me pare do te llogaritet ne shume e çmimit te përgjithshme.

Gjykata ka vlerësuar në cilësinë e provave materiale edhe aneks-kontratën për ndarjen njësive ndërtimore nga ndërtimi i përbashkët nr.i LRP.4654/2018 dhe Nr.i Ref.983/2018 e dt.04.05 dhe kontrata për ndërtim te përbashkët Nr.LRP.8235/2016 dhe Nr.i Ref.1395/2016 e dt.03.10.2016; përgjigja e Drejtorisë Kadastrale te Komunës se Prishtinës e dt.20.05.2021; përgjigja e odes se noterëve te Kosovës nr.Ref.20/2021 e dt.30.05.2021; autorizimi për përfaqësim i noterizuar LRP.nr.3230/2017 i dt.6.04.2017; bisedat në Viber të pandehurit L.K me dt.18.02.2021 me personin me emrin e regjistruar E., me dt.20.02.2021 me personin e regjistruar si A.XH Banjo, dhe komunikimin përmes email me A.Z, me dt.16.02.2021, nga të cilat ka vërtetuar se A.Z, është pronar i disa njësive banesore ne kompleksin banesor “Pozhegu Brother” të fituara në bazë të kontratës për ndërtim të përbashkët dhe aneks kontrata për ndarjen njësive ndërtimore nga ndërtimi i përbashkët, se i njëjti e ka autorizuar motrën e tij S.Z.K, njëherit bashkëshortja e të pandehurit L., që të ketë mundësi të disponoj me paluajtshmerit e përshkruara si në autorizim, se i akuzuari L. ka biseduar me A.Z për mundësin e blerjes se dy njësive banesore me garazh, se i akuzuari L. ka komunikuar me persona/kompani për materiale të ndryshme, që lidhen pikërisht me këto banesa, mirëpo që me asnjërin nga këto prova nuk rezulton i vërtetuar fakti pretenduar nga organi i ndjekjes se vërtet në këtë rast lidhur me këto banesa është lidhur ndonjë raport i caktuar juridik i shitblerjes se tyre, dhe për me tepër që shuma prej 10.000 euro të jetë dhënë në funksion të përmbushjes së këtij detyrimi, mirëpo që nga komunikimi përmes email-it i të akuzuarit L. me A.Z, vërtetohet fakti se para në shumë prej 10.000 euro ishin dhënë në emër të huas, këtu e disa vite me parë, siç vërtetohet edhe nga ekspertiza financiare lidhur me kohen dhe arsyen e transferimit të kësaj shume në emër të A.Z, ndërkaq që nga ky komunikim rezulton

se është biseduar që në rast blerjes së banesave nga i akuzuari L., kjo shumë do llogaritej në shumën e pagesës së banesave të blera.

Nga Kallëzimi penal i ushtruar i dorëzuar nga A.K në emër të B.M, vërtetohet se i njëjti është ushtruar kundër të dyshuarve P.Z. dhe SH.V. në drejtim të veprës penale Falsifikimi i dokumenteve. Gjykata të njëjtin nuk e ka vlerësuar pasi që e njëjta ka të bëjë për të pandehurin A.K.

### **Vlerësimi ligjor**

Sa i përket pjesës gjyquese të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pas procedimit të gjitha provave personale dhe materiale e të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, të vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 360 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, gjykata vërtetohet gjendjen faktike të precizuar si në pjesën gjyquese të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që bazuar në një gjendje të tillë faktike, të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë lidhur me këtë çështje penale, kjo gjykatë vlerëson se në veprimet se te e akuzuara M.B, manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale Falsifikimi i dokumenteve sipas neni 390 par.1 të KPRK-së .

Sa i përket të akuzuarës M.B për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 par.1 të KPRK-së, Gjykata thekson se formën themelore të kësaj veprë penale e kryen ai që përpilon një dokument të rremë apo që ndryshon dokumentin origjinal, me qëllim që atë ta përdorë si të vërtetë ose kushdo që një dokument të tillë e përdor si të vërtetë. Ndërsa që në paragrafin 2 është parashikuar forma e kualifikuar e kësaj veprë penale, bazuar në llojin e dokumentit që është objekt falsifikimi, ashtu që në këtë rast kërkohet të vërtetohet se përpilimi i dokumentit të rremë, ndryshimi i dokumentit origjinal dhe përdorimi i një dokumentit të tillë, të jetë dokumenti publik, testamenti, kambiali, regjistri publik a zyrtar ose ndonjë regjistër tjetër që ruhet në bazë të ligjit. Lidhur me të akuzuarën M.B, po ashtu janë vërtetuar bindshëm rrethanat se e njëjta ka përpiluar dokument të falsifikuar me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal, kjo pasi që rrethana e të qenit i falsifikuar rezulton e vërtetuar nga raporti i ekspertimit AKF/2021-0908/2021-850 i dt.21.04.2021 të punuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzik, sipas të cilit nënshkrimi tek pjesa deklaruesi në Deklaratën e dt.16.12.2019 nuk është e tani dëshmitarit Bashkëpunues B.M, po ashtu edhe dëshmia e dëshmitarit S.B, sipas të cilit në zyrën e tij nuk është bërë kjo deklarata, çka vërteton përbujtjen e rrem të kësaj deklarate sa i përket vendit ku pretendohet se është përpiluar dhe pagesës kesh parave në atë vend. Sa i përket qëllimit për përdorim në funksion të dëshmimit të fakteve përkatës për marrëdhëniet juridike të caktuara, gjykata vlerëson se edhe ky element është përmbushur, pasi që synimi, ka qenë dëshmimi i fakteve përkatës për marrëdhëniet juridike lidhur me blerjen e veturës, pagimin e shumës së caktuar të mjeteve në emër të pagimit të çmimit për blerjen e të njëjtës, dhe vendin e kryesës së kësaj pagese, dhe se ky qëllimi i pandehurës M., vërtetohet dhe nga fakti që e njëjta këtë dokument/deklarata e ka përdorur në seancën për caktimin e paraburgimit, duke pretenduar mbi vërtetësinë e këtij dokumenti dhe fakteve që konstatohen në të njëjtin.

Sa i përket pjesës lirues të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për të akuzuarit L.K, M.B dhe F.D, gjykata vlerëson se nga provat e administruara nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mire se tani të akuzuarit kanë kryer këto vepra penale për kryerjen e të cilave janë akuzuar.



Ashtu që lidhur me të akuzuarit L.K, gjykata vlerëson se në veprimet e të njëjtit nuk manifestohen elementet e veprës penale Ushtrim ndikimi nga neni 424 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pasi që në përmbajtjen e saj, kjo dispozitë parashikon që “Kushdo që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin tjetër, ose pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, me pretendimin se ai apo ajo është në gjendje të ushtrojë ndikim të padrejtë mbi vendimmarrjen e personit zyrtar, zyrtarit të huaj publik ose personit të huaj zyrtar, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ndikimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar...”. Të pandehurit L.K dhe A.K, janë akuzuar për kryerjen e kësaj vepre penale në bashkëkryerje, ashtu që gjatë vitit 2018 dhe vitit 2019, në vende të ndryshme kanë kërkuar dhe pranuar shumë të ndryshme financiare në lartësi totale prej 40.000 euro, si dhe veturën e tipit “VW T-roc” për tani të akuzuarën M.B, në vlerë prej 25.000 euro nga B.M, duke i premtuar të njëjtit se do të ushtrojnë ndikimin e tyre mbi vendimmarrjen e personit zyrtar, në kolegjin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për ulje të dënimit dhe shtyrjen e ekzekutimit të dënimit, për të dënuarin B.M, mirëpo që nga provat e administruara nuk është provuar ekzistimi i këtyre rrethanave, vërtetimi i të cilave do të konsumonte elementet e kësaj vepre penale. Prova kryesore mbi të cilën është mbështetur akuzua ka qenë dëshmia e dëshmitarit bashkëpunues B.M, mirëpo që siç është theksuar edhe me lart në këtë aktgjykim, dëshmitari ka qenë kontradiktor në rrethanat kryesore, përfshirë edhe kohën kur pretendon se i janë kërkuar shumat e parave në emër të ndikimit në procedurën penale dhe kinse rezultatit të arritur përmes këtij ndikimi, kjo pasi që dëshmitari pretendon se me të akuzuarin A. është takuar për herë të parë në muajin mars apo prill të vitit 2019 dhe ku i është premtuar se do të ndikoj në çështjen tij, dhe pas një kohe të shkurtër here thotë 2 ore e herë dy dite, është takuar përsëri, dhe nga A. i është thënë se lënda i është kthyer në rigjykim, gjë që dëshmitari e ka vërtetuar edhe përmes avokatit të tij, se lënda vërtet i është kthyer në rivendosje, ndërsa që nga aktgjykim i Gjykatës Supreme rezulton se kjo Gjykata ka vendosur në muajin Korrik lidhur me këtë çështje, pra disa muaj me pas, pra ka një mospërputhje në kohë që është thelbësore te natyra e veprimeve që pretendohet se janë ndërmarr, meqenëse kjo mos përputhje, e rrezon në tërësi, gjithë skemën e pretenduar për mënyrën dhe arsyet që është ushtruar ndikim, përkatësisht janë kërkuar dhe marr para në emër të ushtrimit të ndikimit. Pastaj në dispozitiv të aktakuzës, përshkruhet koha 2018-2019, ndërsa që vetë dëshmitari bashkëpunues ka dëshmuar se për herë të parë është takuar me A.in në muajin Mars-Prill 2019, dhe se para kësaj date nuk është njohur e as takuar me të njëjtin, kështu që është e qartë se para kësaj date duke mos e njohur, as që ka mundur të kërkojë ndonjë gjë, edhe në emër të kryerjes së ndonjë pune, përfshirë ushtrimin e ndikimit në ndonjë institucion. Është vërtetuar, rrethana se i akuzuari A. ka pranuar shuma të caktuara të parave nga dëshmitari bashkëpunues B.M, gjë që pjesërisht e ka pranuar edhe vetë i akuzuari A., duke pretenduar se janë hua të marra nga i njëjti, mirëpo që nuk është vërtetuar se të njëjta janë marr për të ushtruar ndikim, në kolegjin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, apo në ndonjë kolegji a institucion tjetër, siç pretendohet në aktakuzën e ngritur, meqenëse është e domosdoshme të vërtetohet se prani i shumave të parave është bërë në mënyrë që të ushtrojë ndikim, dhe se pranimi i shumave apo premtimi, të jetë bërë për veprimin/ndikimin që do të ushtrohen në të ardhmen, dhe pikërisht për këtë kohë është shumë e rëndësishme, lidhur me vërtetimin e pajtimit për ushtrim ndikimi kundrejt pranimi apo premtimit për shumë të caktuar të parave.

Sa i përket veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga 414 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kjo vepër penale ekziston kur personi zyrtar a përgjegjës, duke shfrytëzuar pozitën e vet zyrtare apo autorizimet, me tejkalimin e kufijve të autorizimeve të tij, ose duke mos i kryer detyrat e veta zyrtare, përfiton për vete a për tjetrin “ose organizatën e biznesit” çfarëdo dobie, i shkakton dëm tjetrit ose shkel seriozisht të drejtat e personit tjetër, pra veprimi i kryerjes është përcaktuar në mënyrë alternative, dhe vepra penale paraqitet në tri forma, që janë: shfrytëzimi i pozitës zyrtare (shpërdorim) apo autorizimeve, tejkalimi i autorizimeve zyrtare dhe mos përmbushja e detyrave zyrtarë (moskryerja e detyrimeve zyrtare). Mirëpo gjykata vlerëson se nuk është vërtetuar se i akuzuari L.K, të ketë qenë në dijeni dhe aq me tepër të këtë dhënë miratimin apo të këtë urdhëruar të akuzuarin A., për dërgimin e A.M për në Republikën e Shqipërisë, dhe në këtë drejtim, nuk është administruar asnjë provë për vërtetimin e kësaj rrethane, përveç dëshmisë së dëshmitarit bashkëpunues B.M, e cila dëshmi siç është arsyetuar edhe më lart në këtë aktgjykim, është thellësisht e dëmtuar në besueshmërinë e saj, për këtë dhe shumë rrethana tjera, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të shërbej si bazë për tu konsideruar e vërtetuar kjo rrethanë. Gjykata vlerëson se nuk është e mjaftueshme, dhe nuk mund të shërbej si premisë raporti ndërmjet të akuzuarit L. dhe të akuzuarit A., për të arritur në përfundimin se vërtet ka qenë në dijeni, ka dhënë miratimin e tij apo edhe të këtë urdhëruar të pandehurin A. për transportimin A.M për në Republikën e Shqipërisë. Sigurisht që një relacion të tillë, ngre dyshime mbi dijeninë e të pandehurit L. për veprimet e shoferit të tij, të pandehurit A., por në asnjë mënyrë nuk mund të shërbej si provë për vërtetimin e këtyre dyshimeve. Prandaj dhe ka vlerësuar se i akuzuari L.K duhet të lirohet nga akuza se në bashkëkryerje me të akuzuarin A. ka kryer këtë veprë penale.

Lidhur me veprën penale Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 430 par.2 të KPRK-së, gjykata ka vlerësuar se nuk janë përmbushur elementet e kësaj veprë penale, pasi që TGJ në rigjykim ka vlerësuar të gjitha provat materiale dhe personale dhe me bindje ka vlerësuar se nuk përmbushën elementet e veprës penale me vetë faktin se në formularin e deklarimit të pasurisë të vitit 2020 i cili është deklaruar në vitin 2021 ka deklaruar banesën të cilën i'a ka shitur dëshmitarit F.A, andaj po të deklaronte banesën e shitur dhe paratë atëherë do të ishte deklarim i pasaktë i pasurisë, kjo vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitarit F.A, i cili ka deklaruar se banesën e ka blerë nga i pandehuri L., në shumë prej 65,000 euro ku për të njëjtën ka hy kredi, ku pas marrjes së të njëjtës, paratë në vlerë prej 40,000 euro i'a ka transferuar në llogari, ndërsa pjesën tjetër i'a kishte paguar më vonë pas pranimit të banesës, gjithashtu TGJ ka vlerësuar se periudha kohore ku është duhet të deklarohet pasuria e personave zyrtar e cila është nga data 01 deri më datën 31 të muajit Mars të çdo viti kalendarik, ku i pandehuri L. në këtë periudhë kohore, përkatësisht nga data 01.03.2021 deri me datën 30.03.2021 ka qenë në masën e paraburgimit, ndërsa me datën 30 mars, masa e paraburgimit i'u ka zëvendësuar me masën e arrestit shtëpiak, kjo vërtetohet edhe nga aktvendimet e kësaj gjykata, andaj në rastin konkret i njëjti derisa ka qenë në masën e paraburgimit nuk ka pasur mundësi që të deklaroj pasurinë e tij, ndërsa në momentin kur i'u zëvendësuar masa paraburgimit në arreste shtëpiak, i njëjti ka pasur vetëm një ditë kohë dispozicion që të deklarojë pasurin, shto kësaj që edhe masa e arrestit shtëpiak ka qenë masë kufizuese për qarkullimin e tij në liri. Gjykata vlerëson se për tu përmbushur elementet e veprës penale është e domosdoshme që të vërtetohet dashja-qëllimi që është element subjektiv i

veprës penale, me vetë faktin se i pandehuri i ka pranuar paratë në llogarin e tij bankare ku ka qenë duke e pranuar edhe pagën dhe kjo llogari ka qenë e deklaruar në vitet parapare të AKK-së, rezulton se i njëjti nuk ka pasur dashja-qëllim për deklarim të rrem të pasuris.

Lidhur me të akuzuarit L.K dhe F.D për shkak të veprës penale në kryer në bashkëkryerje: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, gjykata po ashtu ka vlerësuar se të njëjtit nuk e kanë kryer këtë vepër penale, meqenëse nuk është vërtetuar se të njëjtit kanë vepruar në kundërshtim me ligjin për prokurim publik, apo të kenë pasur qëllim të sigurimit të dobisë pasurore të kundërligjshme duke e favorizuar Operatoret Ekonomike “G...Shkup” dhe “S...”, përmes zhvillimit të procedurave fiktive, dhe me këtë i kanë diskriminuar Operatoret tjerë ekonomik, të cilët kanë marr pjesë të tender. Nga provat e administruara, është vërtetuar fakti se nuk është kontestuese që një kontrata e KPK-së ka qenë e lidhur me Operatorin Ekonomik “M...” për furnizim me mobilie, në rastin konkret janë kërkuar mobilie me karakteristikat specifike të cilat nuk janë përfshirë në këtë kontratë, dhe procedura e prokurimit është iniciuar pasi që është marr aprovimi paraprak, nga AQP, se mund të zhvillohet procedurë e prokurimi për mobile me karakteristika që nuk përfshihen në kontratën ekzistuese, pra, fakti që ka pasur kontratën fuqi për furnizim me mobilie, nuk mund të konstatohet se ka shkelje me iniciimin e procedurës se re. Po ashtu, nuk është provuar se procedura ka qenë fiktive, meqenëse, janë respektuar të gjitha procedura ligjore, sa i përket njoftimit, pranimi të ofertave, shpalljes së tyre, mundësisë për ankesa eventuale, dhe nuk rezulton se ofertuesit tjerë të përfshirë të kenë deponuar ankesa eventuale për të kontestuar procesin në tërësi apo ndonjë pjesë të tij, ndërsa që operatori ekonomik “G...”, është kompensuar sipas kontratës dhe pas pranimi të raportit të komisionit pranues se ky operator ka përmbushur obligimet në tërësi sipas kontratës. Fakti se një pjesë e mobilieve janë pranuar nga një operator tjetër ekonomik, është çështje e operatorit ekonomik fitues, lidhur me mënyrën si vendos me përmbush kontratën, ndërsa që kërkesa e të akuzuarën F., në raport me operatorin ekonomik “Solo”, siç ka dëshmuar dëshmitari B.L nuk ka pas karakter detyrues dhe ka qenë në të drejtën e tij, ta përmbush ose jo, sikur të ishim në kushtet e fiktivitetit të procedurës, do përzgjidhje operatori ekonomik “S...”, e cila edhe ka siguruar një pjesë të mobileve, dhe jo të paraqitje si kërkesë tek operatori ekonomik “G...”, që nëse e vlerëson të leverdishme, një pjesë të mobileve të marr tek kompania tjetër. Fakti që një pjesë e caktuar e mobileve janë pranuar, para përfundimit të procedurës së prokurimit, nuk mund të shërbej si provë se fituesi ka qenë i paracaktuar, e atëherë me pak që e gjithë procedura ka qenë fiktive, meqenëse fitues është shpallur një operator tjetër, në drejtën e të cilit ka qenë të vendos për mënyrën e përmbushjes së kontratës, ndërsa që nga dosja e tenderit, nuk rezulton se ndonjëri nga ofertuesit tjerë, të këtë ofruar kushte me të favorshme se ofertuesi i shpallur fitues. Sa i përket të akuzuarit L.K në cilësinë e zyrtarit kryesor administrativë, ka kryer veprimet e nevojshme formale siç është nënshkrimi i Formulari i dt.27.01.2021, për disponueshmërin e mjeteve, nxjerra e vendimeve për themelimin e Komisionit për pranimin e projektit dhe caktimin e menaxherit të kontratës, dhe me këto veprime, kanë përfunduar përgjegjësit e të pandehurit L.K, në cilësinë e zyrtarit kryesor administrativë, sa i përket procedurës së tenderimit në projektin “Furnizim me mobileje ekskluzive për kabinetin e ... të Republikës së Kosovës me nr. identifikues PSH250-021-001-136”, dhe për mënyrën e zhvillimit të procedurave, përzgjedhjen e fituesit, pranimi të punëve të kryera dhe veprime tjera, janë në përgjegjësi të zyrës së prokurimit dhe personave të caktuar në cilësitë përkatëse.

Sa i përket të akuzuarës M.B për shkak të veprës penale “Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par.1 të KPRK-së, gjykata vëren se forma themelore e kësaj vepre penale ekziston kur dikush sendin, për të cilin e di se është përfitur me vepër penale ose atë që është fituar me një send të tillë të shitur apo të këmbyer, e blen, e pranon si hipotekë apo në ndonjë mënyrë tjetër e siguron ose e fsheh, pra duhet te vërtetohet se sendi është fituar me vepër penale ose ajo që është fituar me shitjen apo këmbimin e sendeve të tilla, dhe se personi e ka ditur sendi është vënë në dorë me vepër penale. Në rastin konkret, nuk është përmbushu asnjëri nga këto elemente qenësore që përbejnë figurën e kësaj vepre penale, pra nuk është vërtetuar se vetura e tipit “VW T-roc”, është fituar me vepër penale, pra të jetë rezultat i ndonjë vepre penale të kryer, meqenëse në këtë rast, është e domosdoshme të vërtetohet paraprakisht, se sendi është përfitur me vepër penale, ndërsa që nga provat e administruar në këtë çështje penale është vërtetuar se veturën e tipit “VË T-roc”, e akuzuara M... e ka blerë nga tani dëshmitari bashkëpunues B.M, përmes kontratës së shitblerjes e cila është lidhur në një zyre noteriale, ku në cilësinë e shitësit me autorizim rezulton B.M, me çmimin prej 7000 euro që figuron në kontratën e shitjes, ndërsa që gjykata e ka gjetur të besueshme shpjegimet e dhëna nga e akuzuara M..., se çmimi real i paguar për veturën e blerë është 17.000 euro, kjo pasi që, siç rezulton nga gjendja e llogaris bankare, deponimeve, tërheqjeve dhe transferove të kryera me datë 16.12.2019, në ditën kur është lidhur kontrata e shitblerjes së veturës, nga e akuzuara M... fillimisht është tërhequr shuma prej 10.000 euro, nga shuma e tërësishme prej 17.000 euro e cila ishte siguruar nga kredia e marr, çka është në pajtim me pohimin e të akuzuarës se kjo shumë në të cilën janë përfshirë edhe dënimit, i është paguar B.M kesh, ndërsa që shuma prej 7.000 euro i është transferuar në xhirollogari bankare, siç rezultojnë dhe nga gjendja llogaris lidhur me transferet e dt.16.12.2019.

### **Vlerësimi i pretendimeve të palëve në procedurë**

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e organit të akuzës, sa i përket vepra penale dhe për të akuzuarit të cilët janë liruar nga akuzat, dhe të njëjtat i ka gjetur të pabazuara, për arsyeje të cilat janë dhënë më lart në këtë aktgjykim. Sa i përket pretendimeve për veprën penale Ushtrimi i Ndikimit nga neni 424 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së gjykata e gjen në veçanti të nevojshme të theksoj pretendimin e prokurorit të shtetit se i akuzuari L. lidhur me çështjen B.M e kishte kontaktuar kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, mirëpo përkundër se këtë rrethanë e ka përmendur disa herë, në asnjë rast, nuk ka propozuar ndonjë provë konkrete për vërtetimin e kësaj rrethane, përfshirë propozimin e kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, në cilësinë e dëshmitari, apo nëse kryeprokurori të ketë ndërmarr ndonjë veprim lidhur me tentimin për ushtruar ndikim tek ai apo përmes tij nga i akuzuari L.K, meqenëse një situatë e tillë, siç pretendohet, një veprim i tillë është dashur të denoncohet dhe hetohet. Pretendim se “në janar të vitit 2018...”, nuk mbështet as edhe nga vetë provat e propozuara në aktakuzë, meqenëse, dëshmitari bashkëpunues B.M, si kohë kur është takuar me të akuzuarin A.K e ka përmendur muajin mars/prill 2019, pra shumë kohë me pas se sa pretendohet në aktakuzë, dhe jo vetëm për këtë rrethanë, mirëpo thuajse për të gjitha rrethanat, burim i vetëm apo kryesor në vërtetimin e tyre paraqitet B.M, dëshmia e të cilit në shumicën e absolute të saj, është në kontradikta brenda vetës por edhe me provat materiale të administruara në këtë çështje penale. Po ashtu pretendohet se me datën 04.12.2019....me datën 06.12.2019 me datën 16.12.2019...” Janë pranuar të holla,

nga të akuzuarit L. dhe A., “duke premtuar se do të ushtrojnë ndikimin e tyre mbi vendimmarrjen e personit zyrtar, në Kolegjin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, për uljen e dënimit, sipas Kërkesës për Mbrojtje të ligjshmërisë, për të dënuarin B.M, si dhe të shtyhet ekzekutimi i dënimit për te njëjtin”, mirëpo siç rezulton nga Aktgjykimi i nxjerr nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, ky aktgjykim është nxjerr në muajin Korrik 2019, nuk kuptohet se si do premtohet se do të ndikohet në Kolegjin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, për një vendim që tanimë vetëm është nxjerr. Pretendohet se shuma e pranuar nga të akuzuarit L. dhe A. është 40.000 €, dhe në këtë rast, kjo shumë është pretenduar të vërtetohet vetëm përmes dëshmitarit bashkëpunues B.M, i cili po ashtu veturës së tipit “VW T-roc”, i ka dhënë vlerën prej 25.000 €, duke mos u ndalur të vlera, përtej pohimeve të këtij dëshmitari, nuk është administruar asnjë provë tjetër që vërteton këto rrethana, përkundrazi, janë administruar prova, nga të cilat rezultojnë të jenë kontradiktore, pasi që dëshmitarit bashkëpunues B.M ka pretenduar se ua ka dhënë shumën prej 15.000 euro të akuzuarit A., me qëllim që të bëjnë pagesën në formë bankare lidhur me veturën, ashtu që të njëjta të i deponojnë në bankë dhe të i transferojnë në xhirollogarinë e dëshmitarit si shitës i veturës (edhe lidhur me këtë rrethanë, dëshmitari herë ka thënë se nënshkrues i kontratës dhe pranues i mjeteve ka qenë vetë ai, e herë se as nuk e ka nënshkruar kontratën dhe as nuk i ka pranuar mjetet), mirëpo nuk rezulton se në xhirollogarinë e M.B të jenë deponuar mjete, në kohën kur pretendon dëshmitari bashkëpunues B.M, por përkundrazi, është vërtetuar se e akuzuara M... ka marr kredi në shumën prej 17.000.00 dhe nga ajo shumë, shuma prej 7.000 euro i është transferuar në xhirollogari B.M. Këto prova dhe jo vetëm nuk të injorohen, edhe në zbatim të dispozitës ligjore nga neni 7 i KPPK-se, sipas të cilit “gjykata, prokurori i shtetit dhe policia që marrin pjesë në procedurë penale detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij...”.

Po ashtu pretendimi se nuk është dashur në asnjë mënyrë të nënshkruhet një kontratë e re, përderisa ka qenë në fuqi kontrata me operatorin “M...”, është i pabazuar, pasi që siç është theksuar edhe më lartë, gjykata ka vërtetuar faktin, se fillimisht është marr miratimi i AQP-së dhe pastaj është vazhduar me fillimin e procedurave të tenderimit, dhe se po ashtu nuk rezulton i vërtetuar pohimi se është ditur fituesi, i tenderit, meqenëse janë pranuar paraprakisht mobilet e caktuara për të cilat ka qenë duke u zhvilluar procedurë e tenderimit, meqenëse në procedurë kanë marr pjesë më shumë se një ofertues, dhe asnjëri nga ta, nuk është ankuar lidhur me procesin apo rezultatin, pra fakti se janë pranuar paraprakisht artikuj të caktuar, nuk mund të rezultojë i provuar fakti se kemi të bëjmë me procedurë fiktive dhe paracaktues të fituesit. Në këtë drejtim, edhe pretendim lidhur me të akuzuarin L., për ndikim në procedurën, e cila nuk rezulton të jetë e zhvilluar në kundërshtim me ligjin, është krejt i pabazuar, meqenëse, pjesëmarrja e tij, është krejt e reduktuar sipas dispozitave ligjore, ashtu që procedura zhvillohet nga zyra e prokurimit, dhe fakti që ka qenë zyrtari kryesor administrativ, nuk mund të shërbej si provë, për ta ngarkuar me përgjegjësi penale, në rast se procedura do zhvillohej në kundërshtim me ligjin, përveç nëse vërtetohet për ndikim të drejtpërdrejtë, që në këtë rast nuk rezulton e tillë.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarve L.K dhe të F.D të njëjtin e ka gjetur të sinqertë dhe bindëse dhe të bazuar dhe me provat tjera si ato persona ashtu dhe ato materiale sa i përket veprave penale për të cilat janë akuzuar.

Gjykata vlerësuar edhe pretendimet e mbrojtjes së të akuzuarës M..., të cilat po ashtu i ka gjetur pjesërisht të bazuara dhe atë sa i përket veprës penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituar me kryerjen e veprës penale sipas nenit 333, par.1 të KPRK-së ndërsa që sa i përket veprës penale Falsifikimi i dokumenteve sipas neni 390, par.1 të KPRK-së, këto pretendime i gjen si të pabazuara, pasi që edhe vetë mbrojtja pjesërisht e pohon faktin se dokumenti/deklarata është përpiluar nga vetë e pandehura M..., por që qëllim i përpilimit të këtij dokumenti sipas mbrojtjes nuk ka qenë përdorimi i tij, pastaj për të njëjtën rrethanë pretendohet se është përpiluar nga e akuzuara M... dhe është nënshkruar nga B.M, mirëpo gjykata thekson fakti që është përpiluar ky dokumenti, dhe bazuar në faktet që konstatohen në këtë deklarata, rezulton i vërtetuar qëllimi i përpilimit ka qenë përdorimi i tij në funksion të dëshmimit të fakteve përkatës për marrëdhëniet juridike në të cilën në cilësinë blerëses figuron e pandehura M.B, dhe se qëllimi i pandehurës M... vërtetohet edhe nga fakti që e njëjta këtë dokument/deklarata e ka përdorur në seancën për caktimin e paraburgimit, duke pretenduar mbi vërtetësinë e të njëjtit dhe fakteve që konstatohen në të njëjtin. Pretendimi i mbrojtjes se deklarata e dt.16.12.2019 nuk konsiderohet dokument zyrtar, dhe se asnjëherë kjo deklarata nuk është përdorur si dokument zyrtar, është i saktë në vetë vete, mirëpo i gabuar në rastin konkret, meqenëse për të konsumuar elementet e kësaj vepre penale, nuk kërkohet që dokumenti të jetë zyrtar apo publik, meqenëse mjafton të vërtetohet se është përpilon një dokument të rremë apo që është ndryshuar një dokumentin origjinal, me qëllim që të përdoret si të vërtetë, për tu konsumuar elementet e kësaj vepre penale.

Gjykata ka vlerësuar pretendimin e mbrojtjes së të pandehurës M... Berisha, dhënë në fjalën përfundimtare lidhur me atë se mostrat e marra, lidhur me ekspertizën nga AKF, konkretisht procesverbali i marrjes së mostrave nga dëshmitari bashkëpunues B.M në prokurori me datë 26.03.2021 me pretendimin se të njëjtin nuk e ka nënshkruar edhe prokurori i rastit, por vetëm bashkëpunëtorja profesionale dhe dëshmitari bashkëpunues, gjykata vlerëson se një konstatim se prokurori nuk e ka nënshkruar procesverbalin qëndron, mirëpo e njëjta mostër nuk mund të jetë e kundërligjshëm pasi që dëshmitari bashkëpunues vetë e ka pohuar se këto mostra i ka dhënë në prokurori, mostrat janë marr në mënyrë të ligjshëm, andaj gjykata vlerëson se një pretendim i mbrojtjes është i pa bazuar.

Gjykata në këtë rishqyrtim gjyqësor ka refuzuar propozimin e prokurorit të shtetit që të përpilohet edhe një ekspertizë e re, me pretendimin se procesi i prokurimit nuk është kryer konform dispozitave edhe gjatë hetimeve nga prokurori paraparak inicimi i kërkesë është dashur të kryhet nga udhëheqësi i divizionit për shërbime të përgjithshme e jo nga asistentja e sekretarit të përgjithshëm, si dhe për sjelljen e malli para lidhjes së kontratë, një propozim të tillë gjykata e ka refuzuar për përpilimin e një ekspertize të re të prokurimit, pasi që gjykata ka vlerësuar se ekspertiza e bërë ka qenë pas propozimit të prokurorit të shtetit ku e njëjta i ka paraqitur pyetjet për ekspertin e cila është përgjigjur në të gjitha pyetjet dhe lidhur me pretendimin e prokurues se kush është dashtë të bëjë kërkesë për iniciimin e procedurave të prokurimit gjykata vlerëson se kjo pjesë nuk ka të bëjë me dispozitivin e V të aktakuzës, ndërsa lidhur me atë se kur është pranuar malli ekspertja e ka shpjeguar edhe në ekspertizë edhe në shqyrtim gjyqësor, gjithashtu kjo mbështet edhe në deklarinimin e dëshmitarëve të cilët kanë qenë anëtarë të komisionit të pranimit, të cilët kanë dëshmuar se pranimi i mallit është bërë pas nënshkrimit të kontratës e kjo mbështet edhe në procesverbalin mbi pranim të mallit.

Me rastin e vlerësimit të rrethanave të cilat ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, për të akuzuarit në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës, gjykata ka vlerësuar rrethana lehtësuese, faktin se e akuzuara t nuk kanë qenë më parë të gjykuar apo të dënuar për ndonjë veprë tjetër penale, sjelljen korrekte gjatë zhvillimit të kësaj procedure penale, si dhe sjelljen e tyre pas kryerjes së kësaj veprë penale. Andaj, ka vlerësuar se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me dënim me gjobë lidhur me të akuzuarën M.B, duke vlerësuar se dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarës, çka është edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së.

Për të pandehurën M.K, vendimi për shpenzimet e procedurës penale do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprave penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale, ku në këtë çështje janë mbajtur shumë seanca gjyqësore, si dhe gjendjen pasurore të saj, konform nenit 449 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 452 par.1, ndërsa për të pjesën lirues të aktgjykimit shpenzimet bien në barrën buxhetore të kësaj gjykate në bazë të nenit 453 të KPPRK-së.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike është marrë në atë mënyrë që është vlerësuar se të dhënat e mbledhura në procedurë penale, nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të përsëritshëm lidhur me këtë çështje, ndërsa që me marrjen e tyre, procedurë penale do të zvarritej në mënyrë të konsiderueshme, ashtu që gjykata e udhëzon palën e dëmtuar që kërkesën pasurore juridike ta realizojnë në kontest civil, konform nenit 462 par.2 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE**  
**DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**  
**PKR.nr.339/23, datë 25.03.2024**

**G j y q t a r i**

\_\_\_\_\_  
Alban Ajvazi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.